



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 27.11.2018, ora 16:30

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjeve financiare që shoqërojnë projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2019”.
2. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve të Kuvendit për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”.
3. Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj dhe Reme Lala.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Anastas Angjeli, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Vitore Tusha - kandidate për KLSH-në
Bledar Dervishaj – këshilltar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Institucioni i Presidentit të Republikës
Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Gelardina Prodani – Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Mimoza Dhembli – Drejtore e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Gentian Opre – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Fran Brahimi – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Enkeleda Bako – përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
Arber Lleshi – Këshilltar i ministrit të Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Anastas Angjeli – Mirëmbërëma!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe të Financave me këtë rend dite. Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjeve financiare që shoqërojnë buxhetin e vitit 2019.

Si pikë e dytë është shqyrtimi i raporteve të komisioneve për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019” dhe shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”.

Për projektligjet financiare relatorë janë Blerina Gjylameti dhe Ervin Bushati, ndërsa për buxhetin relatorë janë Anastas Agjeli dhe Evis Kushi.

Të ftuar në komision janë: ministri i Financave dhe Ekonomisë, zoti Arben Ahmetaj, sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, zonja Gerardina Prodani, Drejtorja e Buxhetit, zonja Mimoza Dhëmbi dhe me radhë drejtorët Gentjan Opre, Fran Brahimi dhe Nikolla Lera, si dhe një numër këshilltarësh të ministrit të Financave.

Në përputhje me rendin e ditës, sikurse e kemi diskutuar gjatë mbledhjes së kaluar, ku diskutuam në parim dhe miratuam në parim projektligjet e paketës fiskale, do të fillojmë procedurën për secilin ligj nen për nen. Komisioni ka shqyrtuar të gjitha raportet e komisioneve, ka konsideruar vërejtjet dhe sugjerimet që janë bërë dhe të dy relatorët, sipas projektligjeve të caktuara, do të ndjekin miratimin nen për nen, duke bërë edhe sugjerimet apo amendamentet përkatëse për çdo nen dhe më pas do të vazhdojmë me procedurën e tatimit.

Fillojmë me ligjin e parë. Vendimi për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Në mbështetje të neni 81, pika 1 dhe të nenit 100 të Kushtetutës me propozimin e ministrit të Financave dhe të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave vendosi propozimin e projektligjit “Për disa shtresa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës me propozim të Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi:

Në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, të bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

Neni 1.

Zonja Gjylameti dhe zoti Bushati keni vërejtje apo sugjerime për nenin 1?

Ervin Bushati – Për nenin 1 nuk kemi propozime.

Anastas Angjeli – Neni 1 me këtë përmbajtje: “Në pikën 5 të nenit 41, aplikimi i pullave fiskale ndërmjet fjalëve “cigareve” dhe poshtë shtohen fjalët “dhe te duhani i grirë”.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pas pikës 6 të nenit 78 “Përkufizime”, shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

7. “Duhan me ngrohje, klasifikuar me kodin 24039090 të nomenklaturës së kombinuar të mallrave, cilësuar si produkte duhani të riformuara dhe me substanca të tjera që konsumohet nga një proces ngrohjeje nëpërmjet një aparati elektronik për ngrohje duhani të klasifikuar në kodin 85437090, i cili e lejon përdoruesin të thithë avujt nga duhani që gjendet në të”.

Zoti Bushati, a keni vërejtje, sugjerim apo propozim për nenin 2?

Ervin Bushati – Kemi vetëm një sugjerim në qoftë se do të ishte më mirë të ishte me fije, por e lamë në diskrecionin e Ministrisë së Financave. Jemi dakord me fije ose me kilogram?

Anastas Angjeli – Zoti Ministër?

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ne kemi ndjekur logjikën siç e ka direktiva apo Bashkimi Europian, prandaj ngelëm te kjo që kemi prezantuar.

Anastas Angjeli – Atëherë, mbetemi te kjo. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Miratohet neni 2.

Neni 3. Pas pikës 2 të nenit 86 “Penalitetet”, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

3. “Penalitetet për të gjitha shkeljet e kryera në qarkullimin e pullave fiskale gjatë proceseve të porositjes, prodhimit dhe lëvizjes së tyre rregullohen nga ky kre”.

Zoti Bushati, a keni vërejtje për nenin 3?

Ervin Bushati – Në nenin 3, ku parashikohen penalitetet për të gjitha shkeljet e kryera në qarkullimin e pullave fiskale gjatë procesit të porositjes, prodhimit dhe lëvizjes së tyre, Komisioni për Ekonominë dhe Financat propozon që fjalët “prodhimi, lëvizja” të hiqen.

Anastas Angjeli – Cili është propozimi, ju lutem?

Ervin Bushati – Fjalët “prodhimi dhe lëvizja” të hiqen.

Arben Ahmetaj – Zoti Bushati, ne mund t’i heqim këto fjalë, por unë besoj se është një përcaktim më i detajuar. Pra, do të jetë në këtë mënyrë: “Penalitetet janë të gjitha shkeljet e kryera në qarkullimin e pullave fiskale gjatë procesit të porositjes, prodhimit dhe lëvizjes gjatë proceseve të porositjes...” Ngelet vetëm ky, në qoftë se e heqim...

Anastas Angjeli – Jo. Penalitet ka edhe për prodhimin dhe e njëjta gjë mund të ndodhë edhe për lëvizjen.

Arben Ahmetaj – E saktë. Në qoftë se i nxjerrim këto dy hallka, nuk e kemi të plotë.

Anastas Angjeli – Atëherë, neni mbetet ashtu siç ishte. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Miratohet neni 3 sipas përmbajtjes që ka projekti.

Neni 4. Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 88 “Prodhimi klandestin i produkteve të akcizës”, termi “fiskale” zëvendësohet me atë “të akcizës”.

Zoti Bushati?

Ervin Bushati – Neni 4 është në rregull.

Anastas Angjeli – A ka ndonjë pyetje apo sugjerim? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e nenit 4. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Miratohet neni 4 sipas përmbajtjes që ka projekti.

Neni 5. Në shkronjën “c” të pikës 6, të nenit 90: “Teprica ose mangësi në magazinën fiskale dhe në qarkullimin e produkteve që i nënshtrohen akcizës” fjalët “për tentativë për t’iu shmangur produkti nga pagesa e akcizës” hiqen.

Zoti Bushati?

Ervin Bushati - Për nenin 5 jemi dakord.

Anastas Angjeli – A ka ndonjë pyetje apo sugjerim? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e nenit 5. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Miratohet neni 5, sipas përmbajtjes së projektit.

Neni 6. Pas neni 94, shtohet neni 94/1 si më poshtë vijon:

“Neni 94/1. “Shkeljet në qarkullimin e pullave fiskale”. “Tepricat ose mangësitë në pullat fiskale të konstatuara gjatë kontrollit të operatorëve ekonomikë në porositje, prodhim dhe lëvizje përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar për produktet e akcizës të konvertuara në sasi të përkatëse, sipas parashikimeve të këtij ligji”.

Zoti Bushati?

Ervin Bushati – Kemi një propozim për doganat të dakordësuar me Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese. Në të thuhet: “Tepricat ose mangësitë në pullat fiskale mbi 2% të

konstatuara gjatë kontrollit të operatorëve ekonomikë në rastet kur nuk janë depozitues të miratuar përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjoba sa 3-fishi i detyrimeve të akcizës që duheshin paguar produktet e akcizës së konvertuar në sasi të përkatëse”. Pra, kemi 2%-in.

Anastas Angjeli – Jo për 2%-in jam dakord, por këtu ka një problem, nuk jemi konsistent të çështja, sepse e keni reduktuar përsëri atë që kërkonit të reduktonit te neni 3, keni eliminuar pjesën që ka të bëjë me porositje, prodhim dhe lëvizje. Kjo duhet lënë përsëri, sepse e lamë te neni 3.

A jeni dakord, zoti Ministër?

Arben Ahmetaj – Edhe një herë, ju lutem!

Anastas Angjeli – Sugjerimi për 2%-in të mbetet, por në të njëjtën kohë në formulimin e bërë është eliminuar fjala “në porositje, në prodhim dhe në lëvizje”. Përderisa në nenin 3 e lamë të plotë “në porositje, në prodhim dhe në lëvizje”, duhet të mbetet edhe te ky nen.

Arben Ahmetaj – Le të mbetet, sepse në finale 2%-i e kushtëzon, e përjashton nga penaliteti. Pra, deri te 2%-i lejohet, kështu që nuk ka nevojë të fshihet.

Anastas Angjeli – Kush nuk ka nevojë, sepse nuk e kuptova?

Arben Ahmetaj – Termi më lart te 3-shi, atje ku e lamë.

Anastas Angjeli – Përderisa e lamë te 3-shi, duhet të jemi me të njëjtën logjikë edhe te ky nen, sepse këtu është eliminuar me formulimin e ri, sepse është nisur nga logjika që do ta eliminonte edhe te neni 3, ndërkohë që ne e lamë te neni 3.

Duhet të jemi konformë të njëjtës...

Arben Ahmetaj – Edhe mund ta shtojmë, por po ta shtojmë është rudimentare si fjalë...

Anastas Angjeli – Jo, nuk do ta shtojmë, sepse është në projektin tuaj, ndërsa këta duan të hiqet, meqenëse propozuan që të hiqej edhe atje.

Arben Ahmetaj – Edhe sikur ta heqim, edhe po ta lëmë... Pra, po e lamë e lëmë ashtu siç është të plotë. Për këtë rast është rudimentare, megjithatë ne jemi të hapur.

Anastas Angjeli – Pra, mbetet ashtu siç ishte, do të shtojmë vetëm 2%-in. Stafi të mbajë shënim dhe të bëjë korrigjimin. Kush është dakord me vërejtjet dhe sugjerimet që u bënë nga zoti Bushati dhe nga unë? Kundër? Abstenim? Miratohet.

Ervin Bushati – Kemi edhe një propozim tjetër...

Anastas Angjeli – Për prodhimin do ta diskutoni më pas me ekspertët...

Arben Ahmetaj – Do ta rakordojmë në zbardhje për të hequr togfjalëshin ose nëntogfjalëshin, por për këtë duhet të biem dakord.

Anastas Angjeli – Jua thashë do ta rakordoni me ekspertët.

Neni 7. Në shkronjën “a” të nenit 95 “Mbajtja, transportimi ose shitja e produkteve të akcizës pa shënjujes ose ngjyrujes” termi “fiskale” zëvendësohet me atë “të akcizës”.

Zoti Bushati, keni sugjerime për nenin 7?

Ervin Bushati – Jo, jemi në rregull.

Anastas Angjeli – A ka pyetje, diskutime? Jo.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Miratohet neni 7 me përmbajtjen që ka projekti i ardhur nga Këshilli i Ministrave.

Neni 8. Shtojca nr. 1 “Mallrat e tatueshëm me akcizë në Republikën e Shqipërisë” bashkëlidhur ligjit zëvendësohet me shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Ervin Bushati – Këtu kemi një propozim.

Anastas Angjeli – Kush e ka?

Ervin Bushati – Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese ka sjellë një propozim, të cilin, në fakt, ne e kemi riformuluar dhe reduktuar në këtë mënyrë: “Komisioni për Ekonomisë dhe Financat në shtojcën nr. 1 që shoqëron projektligjin propozon që për produktin zhavorr bituminoz me kodin NK 27149000 shkalla e taksimit të bëhet 0,3 lek për kilogram”.

Anastas Angjeli – Ky është propozimi, por ne aq e kemi lënë, 0,3 lek për kilogram.

Arben Ahmetaj – Edhe qeveria është dakord me propozimin e komisionit, ndërkohë...

Ervin Bushati – Ndërkohë, është kërkuar nga Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese që të jenë pjesë e akcizës fishekzjarrët.

Arben Ahmetaj – Edhe për atë jemi dakord. Ne kemi edhe procedurën e akcizës ku folëm për filtrat dhe për letrën.

Ervin Bushati – A ta lexoj edhe këtë?

Arben Ahmetaj – Jemi dakord me 0,3-in zoti Angjeli.

Anastas Angjeli - Një minutë, të përfundojmë këtë. Propozimi që keni rënë dakord është që kalon për zhavorrin bituminoz 0,3 lek për kilogram. Kjo është pjesë e listës.

Propozim tjetër për pjesën e listës janë fishekzjarrët.

Ervin Bushati – Fishekzjarrët, ndryshe nga sa ishte propozimi i Ministrisë së Financave të jenë pjesë e akcizës, pra të mos hiqet akciza.

Anastas Angjeli – A ramë ne dakord kështu?

Ervin Bushati – Po.

Anastas Angjeli – Propozimi i tretë.

Zoti Ministër, ju lutem, propozimi juaj, përveç fishekzjarrëve?

(Diskutime pa mikrofon)

Ervin Bushati – Fishekzjarrët të mbeten në akcizë. Kemi edhe diçka tjetër.

Arben Ahmetaj – Pra, ne e diskutuam, po nuk ka nevojë. Pyetja është shumë e thjeshtë: për zhavorrin bituminoz ramë dakord, për fishekzjarret ramë dakord. Keni propozim tjetër për listën? Ju lutem, kush e ka?

Zoti Bushati, bëni propozimin.

Ervin Bushati – Propozimi për ndryshim i nenit 80/1: “Importimi dhe prodhimi i letrës së cigareve në formën e broshurave apo të tubave që përfshihen në Kodin 4313/1000 të filtrit të cigares që përfshihet në Kodin 4323 dhe 5601 të nomenklaturës së kombinuar të mallrave, kryhet vetëm nga subjekte grumbullues/përpunues të duhanit të pajisur me linja me cikël të plotë përpunimi dhe paketimi për tregtinë, të pajisur me autorizim depozituesi të miratuara magazinë fiskale prodhimi.

Përveç kushteve të përgjithshme, për t’u pajisur me autorizim magazinë fiskale, prodhimi i parashikuar në nenin 20 të ligjit, prodhuesit e duhanit duhet të dëshmojnë se disponojnë linjat teknologjike dhe burimet njerëzore të specializuara në linjat prodhim me cikël të plotë nga përpunimi i gjetheve, tharja, fermentimi, grirja, paketimi me kapacitete përpunuese dhe magazinimi jo më pak se 1000 kg në orë dhe të jenë të pajisur me:

1. Furrë tharje dhe fermentimi
2. Makineri për eliminimin e materialeve joduhanore
3. Dhomë vakumi
4. Cilindër për kondicionimin dhe shtimin e lëngjeve
5. Silos harmonizim i
6. Makinë grirjeje
7. Cilindër tharjeje
8. Siloset e ruajtjes së duhanit të grirë
9. Makinat e paketimit
10. Presat për presimin e duhanit
11. Laboratorë për analizat bazë të duhanit, sipas standardeve në fuqi.

Apeluesi duhet të dëshmojë se ka të punësuar personel të kualifikuar dhe certifikuar me licencë për grumbullimin dhe përpunimin e duhanit për duhane që thahen në rryma të ngrohta, duhane që thahen në hije dhe duhane që thahen në diell jo më pak se 50 punonjës me kohë të plotë”.

Anastas Angjeli - Më fal, zoti Bushati, neni 8, që të jemi të gjithë të qartë, thotë: “Shtojca nr. 1 “mallrat e tatueshëm me akcizë në Republikën e Shqipërisë bashkëlidhur ligjit”, zëvendësohet me shtojcën nr....

E gjithë kjo që thatë është element i shtojcës, apo është propozim neni? Vetëm drejtori i kompanisë nuk ishte përfshirë në listën që futet, dhe kjo nuk vihet në listë.

Arben Ahmetaj – Është e rëndësishme t’ju tregoj se cila është arsyeja. Fjala është gjithmonë për filtrat, apo jo?

Anastas Angjeli - Ishin 17 elemente, nuk ka rëndësi. Në listë do t’i vini këto?

Arben Ahmetaj – Ajo futet në nen dhe reflektohet në shtojcë.

Anastas Angjeli - Në nenin 8 apo është nen më vete? Neni 8 ka të bëjë me listën, nuk ka të bëjë me...

Arben Ahmetaj –Do ta vendosim në nen më vete, them unë.

Anastas Angjeli - Atëherë, ju lutem, se gjithë ajo histori nuk mund të jetë pjesë e listës, veprohet në këtë mënyrë: dy pikat e para, propozimi që ishte për fishekzjarrët dhe propozimi për zhavorrin bituminoz janë pjesë e nenit 8, që është pjesë e listës. Para nenit 8 vendoset një nen më vete, që ka të bëjë me fletën, letrën, gjethen e me radhë të duhanit.

Ekspertët të marrin propozimin dhe ta verifikojnë.

Atëherë, votojmë në fillim amendamentin e nenit 7, të ri, që del para listës, i cili ka të bëjë me çështjen e duhanit. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8, lista bashkëngjitur projektligjit me dy propozimet e bëra për fishekzjarret dhe zhavorrin bituminoz. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9 “Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019”. Ka njeri ndonjë propozim?

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin e paraqitur “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar në tërësi”. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te ligji i dytë “Për propozim të projektligjit për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 27.07.2007 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”.

Projekt “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9975 datë 28. 07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”. Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 dhe 155, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi: “Në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar” bëhen ndryshimet dhe shtesat si vijon:

Neni 1: në nenin 3, llojet e taksave kombëtare, bëhen këto ndryshime dhe shtesa: pika 881, riformulohet si më poshtë vijon:

“ Pika 8, Taksat e materialeve, “në masën sa 1/2 e normës së rentës”

8.1 Materiale, artikuj plastikë konsiderohen mallrat e importuara sipas kapitullit 39 të NKM-së.

8.2 Ambalazh plastik qelqi është çdo material paketues, që shërben për paketimin e produkteve, i cili mund të mbulojë tërësisht ose pjesërisht atë, me qëllim mbrojtjen e produktit nga ndotja, infeksionet, nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe që e bëjnë të përshtatshëm për transport, tregtim, përdorim. Një ambalazh mund të përmbajë disa njësi ose tipa ambalazhesh”.

Kush ka vërejtje apo sugjerime për nenin 1?

Blerina Gjylameti - Nuk ka asnjë propozim për amendime.

Anastas Angjeli – Kalojmë në votim të nenit 1, sipas përmbajtjes që ka projekti i paraqitur. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 1 sipas projektit të paraqitur.

Kalojmë te neni 2. Në nenin 4 “niveli i taksave kombëtare” bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

“1. Në pikën 4, paragrafi i parë dhe i tretë fjalët “në masën sa 1/2 e normës së rentës” të zëvendësohen me “në masën sa 1/3 e normës së rentës”

2. Në fund të pikës 6 shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Kjo taksë nuk paguhet për sasitë e benzinës dhe gazoilit që eksportohet”.

3. Pika 8 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“8. “Taksat e materialeve, artikujve plastikë dhe ambalazheve plastikë të importuara në kapitullin 39 të NKM-së, është 35 lekë për kilogram, me përjashtim të lëndëve të para, në forma primare të importuara në krerët 3901 deri në 3914 të NKM-së”.

Përveç kapitullit 39, kjo taksë zbatohet edhe kur materiali plastik zë të paktën edhe 51 % të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera të importuara, të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të nomenklaturës së kombinuar të mallrave”

8.1 Taksa e lëndëve të para në formë primare të importuara në krerët 3901 deri në 3914 të NKM-së, dhe që përdoret për prodhim në vend të produkteve të plastikës, është 25 lekë për kilogram.

8.2 Taksa e ambalazheve prej qelqi është 5 lekë për kilogram dhe zbatohet për ambalazhe prej qelqi të importuara e prodhuara në vend. Taksa zbatohet për të gjithë artikujt prej qelqi sipas kreut 7010 të NKM-së në rast se ambalazhi importohet vetëm veçmas, si edhe kur materiali i qelqit zë të paktën 80 % të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera. Të klasifikohen kapitujt, krerët, nëkrerët dhe kodet e tjera tarifore të nomenklaturës së kombinuar të mallrave.

8.3 Në rastin e importit taksa e materialeve, artikujve plastikë, lëndëve të para në forma primare për prodhimin e materialeve plastikë, si dhe/e ambalazheve prej plastike apo qelqi llogaritet dhe mbledhet nga administrata doganore në momentin e importit.

8.4 Në rastin e prodhimit brenda vendit, taksa e ambalazheve prej qelqi mbledhet nga administrata tatimore, sipas afateve dhe procedurave të deklarimit në këtë ligj. Administrata tatimore monitoron dhe kontrollon lëndët e para që përdoren për prodhimin e ambalazheve të qelqit, si dhe lëndët e para në forma primare të importuara me qëllim prodhimin e materialeve dhe ambalazheve plastike brenda vendit”.

Ka vërejtje?

Blerina Gjylameti – Te neni 4, pika 1, propozimi nga qeveria ka qenë në paragrafin e parë dhe të tretë, fjalët “në masën sa 1/2 e normës së rentës” të zëvendësohen me “në masën sa 1/3 e normës së rentës”. Propozojmë të mbetet “në masën sa 1/2 e normës së rentës”.

Arben Ahmetaj - T’ju bëj një sqarim. Ka qenë 6 % dhe 3%, po shkon 9% dhe 3%, që do të thotë se është 1/3. Pra, është raport i ngulur, në kuptimin e mirë të fjalës. Ishim 6 % dhe 3%, që ishte 1/2, tani po shkon 9% dhe 3%, pra saktëson raportin kjo.

Blerina Gjylameti – Megjithatë, meqenëse në propozimin që ka ardhur, kemi bërë edhe një ndryshim të mëpasshëm, ndaj jemi të mendimit që duhet të mbetet 1/2. Ne kemi shtrirë në afat kohor ndryshimin e rentës, ndaj është ruajtur kjo 1/2 . Pra, kur të vijmë te pika tjetër, në fund do të bëjmë sqarimet përkatëse, prandaj kemi ngelur në normën 1/2. Meqenëse rritja e rentës minerare për eksportin tashmë do të shtrihet në kohë duke filluar nga viti 2019, 7%, në vitin 2020, 8 %, 2021, 9%, ndaj kemi ngelur të mendimit të vazhdojë të mbetet 1/2, meqenëse nuk ndryshon raporti direkt siç ka qenë, 6 me 3 dhe 6 me 9 tashmë.

Ideja është kjo, që të harmonizohemi me atë që jemi duke diskutuar them unë në të drejtën tuaj dhe në merakun tim, sot është 6 me 3, propozimi juaj racional është që të shkojë 7 në vitin

2019, 8 në vitin 2020 dhe 9 në vitin 2021. Kur të shkojë 9 me 3, është 1 me 3 raporti. Kjo është arsyeja. Ajo që do të sugjeroj unë, në qoftë se biem dakord, është që, përderisa ne po i vendosim kohë, themi...

(Diskutim pa mikrofon)

Mos harroni se rrisni rentën automatikisht po e vendosët $\frac{1}{2}$ për mineralin që shkon në prodhimin e brendshëm. Çfarë dua të them me këtë? Në qoftë se shkon 7, zonja Gjylameti, $\frac{1}{2}$ është 3,5, pra i rrisim rentën, që nuk duhet ta bëjmë këtë, se gjithë logjikën e kemi, pse e hapëm rentën kaq shumë, e hapëm me qëllim që të mbrojmë gjithë rezervën për të shkuar, përderisa kemi kapacitete, pra për të shkuar në përpunimin e brendshëm. Në qoftë se do ta lëmë $\frac{1}{2}$, ecim në kohë, në vitin 2019 po të jetë $\frac{1}{2}$ e rentës, 7 shkon 3,5, që nuk është ky qëllimi i ndryshimit. 8 shkon 4, prapë nuk është ky qëllimi i ndryshimit, 9 shkon 4,5, as ky nuk është qëllimi i ndryshimit. Pra, ajo që sugjeroj është ta definojmë që për periudhën tranzitore, sugjerim e kam dhe ta gjykojmë së bashku...

(Diskutim pa mikrofon)

Edhe ta nominojmë po deshët, 2019-2012, ky raport është i pareferueshëm. Pra, raporti 1 me 3 është i pareferueshëm.

Nuk e di si mendoni ju?

Blerina Gjylameti – Propozimi që ka ardhur edhe nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, është që të mbetet $\frac{1}{2}$, pra ne referojmë vetëm çfarë ka ardhur. Nëse ju jeni dakord, bëjmë edhe këtë që thoni ju, që të ruajmë të njëjtin raport që është sot, pra, duke vazhduar që të mos i referohemi taksës, për sa i përket rentës së mineraleve të përpunuara në tranzicion.

(Diskutim pa mikrofon)

Pra, të ulen ekspertët dhe t'i rakordojnë.

Arben Ahmetaj – Më lejoni, do ta them shumë shkurt. Ideja është kjo, që ne...

Anastas Angjeli – Ne jemi të qartë.

Arben Ahmetaj – A jeni të qartë? Atëherë, në rregull!

Blerina Gjylameti - Pra, ekspertët duhet t'i rakordojnë në formulim.

Person M - Atëherë, duhet ta përcaktojmë pjesën e tranzicionit, sepse si mund ta rrisë rentën 1/2-ta dhe 1/3-ta e ul?! Pra, nëse është 7 dhe themi 1/3-ta do të dalim me 2,1, nuk do të dalim me 3.

Blerina Gjylameti - Pra, ideja është që ne e ulim rentën, prandaj nuk duhet të ndryshojë.

Anastas Angjeli - Meqenëse u arrit një kompromis, atëherë ideja është shumë e qartë që për periudhën e tranzicionit nuk do të kemi rritje. Ekspertët e ministrisë së bashku me ekspertë e komisionit duhet ta formulojnë...

Blerina Gjylameti - Ta formulojnë në mënyrë të tillë që të mbetet e njëjta.

Anastas Angjeli - Po, dhe ta hedhim në votim bashkë me këtë. A ka propozime në lidhje me pikat e nenit 2? Nuk ka.

Atëherë, e hedhim në votim nenin 2, me propozimin e bërë nga zonja Gjylameti dhe referencat që dha ministri.

Blerina Gjylameti - Një sekondë, sepse te neni 2 germa “c” pas pikës 8/4 shtohet pika 8/5 si vijon: “Për ambalazhet plastike dhe qelqi, të cilat eksportohet dhe për të cilat taksa është paguar në momentin e importit, prodhimit të tyre, administrata doganore rimbursion shumën e taksës së paguar. Rimbursimi bëhet sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit të Financave.”

Arben Ahmetaj – Pra, që të kuptohemi. Ideja juaj është për të gjitha ato ambalazhe qelqi, që kanë paguar në import dhe janë në regjim të përkohshëm për shkak të natyrës së prodhimit. Pra, kjo është ideja?

Blerina Gjylameti- Po.

Arben Ahmetaj - Dakord! Këtë pjesë do ta shikojmë me detaje, por mos harroni një gjë, do të ketë shumë produkte të tjera që do ta kërkojnë si regjim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Blerina Gjylameti – Vetëm për qelqin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Anastas Angjeli - A keni ndonjë vërejtje?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk kemi asnjë vërejtje.

Anastas Angjeli - Atëherë, kush është dakord që neni 2 të votohet me dy ndryshimet që u propozuan? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 2, me të dyja propozimet e bëra.

Neni 3. Germa “ë” në nenin 5 “Agjentët e taksave”, riformulohet, me këtë përmbajtje: “ë) Për taksën e materialeve/artikujve plastike dhe taksën e ambalazheve prej plastike/qelqi ngarkohen: I. administrata doganore, në rastet e importit të materialeve/artikujve plastike dhe ambalazheve prej plastike/qelqi; II. administrata tatimore, në rastet e prodhimit brenda vendit të ambalazheve prej qelqi.” A ka propozime?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk kam propozime.

Anastas Angjeli - A ka pyetje? Nuk ka.

Atëherë, hedhim në votim nenin 3. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet neni 3, sipas propozimit të Këshillit të Ministrave.

Neni 4. Germa “e” e pikës 2 në nenin 8 “Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave”, riformulohet si më poshtë vijon: “e) Për taksën e materialeve/artikujve plastike dhe ambalazheve prej plastike/qelqi, 0 për qind;”. A ka pyetje? Nuk ka. A ka vërejtje? Nuk ka. A k propozime? Nuk ka.

Blerina Gjylameti – Nuk kemi propozime për amendime.

Anastas Angjeli - Atëherë, hedhim në votë nenin 4. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 4, sipas propozimit të Këshillit të Ministrave.

Neni 5. Në nenin 9 “Përfjashtimet nga pagimi i taksave kombëtare”, bëhen këto ndryshime: 1) Në pikën 1/1, pas fjalëve “... Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ...”, shtohen “... ose Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit ...”.

2) Në pikën 4 bëhen ndryshimet si më poshtë vijon: a) Fjala e parë riformulohet me këtë përmbajtje: “4. Përfjashtohen nga pagimi i taksës së materialeve/artikujve plastike dhe ambalazheve prej plastike/qelqi, sipas nenit 4”.

b) Në shkronjën “ç”, nënpikat “I”, “II”, “III”, “IV”, “VI” dhe “VII” hiqen.

3) Në shkronjën “ç”, të pikës 7, pas fjalëve “... Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara ...”, shtohen “... ose Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shteti.

A ka propozime për amendime?

Blerina Gjylameti – Nuk kemi propozime për amendime.

Anastas Angjeli - A ka pyetje? Nuk ka. A ka diskutime? Nuk ka.

Blerina Gjylameti – Nuk kemi propozime për amendime.

Anastas Angjeli - Atëherë, hedhim në votë nenin 5. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 5, sipas propozimit të Këshillit të Ministrave.

Neni 6. “Në shtojcën nr. 2 “Renta minerare sipas klasifikimit”, në grupin I, “Mineralet metalike”, në pikën 4, “Mineralet e kromit për eksport”, përqindja e rentës minerare bëhet 9 %.

A ka propozime për nenin 6?

Blerina Gjylameti - Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin sugjeron që ndryshimi të jetë nga viti 2020, duke nisur nga 7, 8 dhe 9%. Ndërkohë, Komisioni i Ekonomisë dhe Financave propozon që kalendari i rritjes së rentës minerare të fillojë nga viti 2019, duke propozuar konkretisht në shtojcën nr. 2 “Renta minerare sipas klasifikimit”, në grupin I, “Mineralet metalike”, në pikën 4, “Mineralet e kromit për eksport”, përqindja e rentës minerare bëhet 7 %, duke filluar nga data 1 janar 2019”; 8% duke filluar nga data 1 janar 2020 dhe 9% duke filluar nga data 1 janar 2021”. Ndërkohë kemi edhe një koment, që ndryshimi duhet të reflektohet edhe në nenin 2, sikundër thamë, që do të mbetet e njëjta normë e rentës për periudhën transitore. Pra, për 3 vjet 2019-2021 të mbetet 3% që është aktualisht sot.

Ndërkohë, Ministria e Energjetikës ka një merak, i cili ishte grupi 1, i mineraleve metalike do të duhet që të reflektohet se nuk duhet të ketë një ndryshim për kromin e varfër që të jetë siç është në grupin e parë, që të mos ketë ndryshim të rentës. Kjo është një gjë që duhet saktësuar nga ana juaj nëse mund të përfshihet apo jo.

Arben Ahmetaj – Ne e kemi saktësuar dhe kjo është sqaruar edhe në parim edhe në administrim, që praktikisht mineralet e kromit janë 1, pavarësisht nga pasuria apo varfëria e mineralit, sigurisht që janë në proporcion me çmimin edhe renta.

Së dyti , jam dakord me logjikën tuaj, që vijmë në vite me rentën, pra nga 1 janari i viti 2019 dhe 1 janar 2021, ndërkohë për periudhën transitore për të mos i konfuzuar me raportet 1 me 2 dhe 1 me 3 le të themi se është 7% dhe tjetra të mbetet 3; është 8 dhe tjetra të mbetet 3, është 9% dhe mbetet 3. Ta sqarojmë në mënyrë nominale.

Blerina Gjylameti – Zoti Ministër, meraku për kromin e varfër është që nuk mund të përpunohet ndaj në shtojcën që keni në grupin 1 të mineraleve është i specifikuar , prandaj duhet ta reflektojnë edhe ekspertët e komisionit së bashku me ekspertët e ministrisë suaj këtë gjë, sepse është krom, i cili nuk përpunohet.

Arben Ahmetaj - Në respekt të asaj që thatë, nuk biem dakord për një arsye: pse eksportohet ky krom i varfër? Ku shkon kur eksportohet? Pra , sigurisht që përpunohet. Kështu, jemi shumë të qartë që do të përpunohet sot, do të përpunohet nesër.

Blerina Gjylameti – Këtë pjesës e dini ju, kurse unë po përcjell vetëm propozimet përkatëse.

Arben Ahmetaj – Doja të bëja edhe sqarimin e duhur, sepse besoj se ia vlen që ta ndajmë edhe si informacion, prandaj e bëra këtë sqarim.

Anasatas Angjeli – Faleminderit, zoti Ministër!

Atëherë, votojmë nenin 6, duke bërë shtesën në fund të këtij neni para 9%, duke vendosur sugjerimin e 7, 8 dhe 9%, sipas viteve që u propozuan këtu.

Blerina Gjylameti - Po dhe shtesën që do të mbesë 3%.

Anastas Angjeli - Po sipas shtesës që thamë: pra hiqet 9% dhe vendoset 7, 8, 9 me 3-shin përkatës në të tre vjetët ekspertët mbajtën shënim dhe është e qartë. A ka pyetje? Nuk ka.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 6, sipas propozimit të Këshillit të Ministrave dhe propozimit të dakordësuar këtu.

Neni 7 “Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019”.

A ka mendime? Nuk ka.

Hedhim në votim nenin 7. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim ? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar””. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji në tërësi.

Kalojmë te projektligji i tretë, te vendimi për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar””.

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 113, pika 1, germa “ç”, 155 dhe 157, pika 3, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi: në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, të bëhen këto ndryshim edhe shtesa:

Neni 1. Në nenin 3 “Përkufizime”, pika 5 “Nivel tregues i taksës” është niveli i taksës mbi biznesin e vogël, i parashikuar në aneksin 5, që i bashkëlidhet këtij ligji”. A ka pyetje?

Po, zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Komisioni i Ligjeve si në nenin 1 dhe në të gjitha nenet e projektligjeve ka propozuar që të mos citohen titujt e neneve që ndryshojnë, pasi është e panevojshme nga teknika legjislative.

Anastas Angjeli – Në rregull!

Teknika legjislative të marrë masat dhe të bëjë korrigjimet sipas sugjerimit të Komisionit të Ligjeve dhe kjo vërejtje të mos përsëritet për të gjitha nenet dhe konsiderohet e mirëqenë për të gjitha nenet. A ka vërejtje të tjera?

Blerina Gjylameti – Për këtë nen nuk kam.

Anastas Angjeli – Atëherë, kalojmë në votim të nenit 1, me sugjerimin e bërë nga Komisioni i Ligjeve. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim ? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Në nenin 5 “Rregulla të përbashkëta për taksat vendore” në fjalinë e parë fjala “bashkisë” zëvendësohet me fjalitë “bashkia nëpërmjet këshillit bashkiak”. A ka sugjerime?

Blerina Gjylameti – Përsëri Komisioni i Ligjeve ka propozuar që fjalët “këshilli bashkiak” të zëvendësohen me fjalën “bashkia”.

Anastas Angjeli – Fjala “bashkia” është dhe ne nuk mund të themi dy herë “bashkia”, por do të lemë vetëm fjalën “bashkia”

Blerina Gjylameti – Po, por të mos jetë “bashkia nëpërmjet këshillit bashkiak”. Pra, të lihet vetëm “bashkia”.

Arben Ahmetaj – Pra, vendoseni si ta mendoni, por kam vetëm një merak: kur themi “bashkia” presupozojmë kryetarin, kurse kur themi “këshilli bashkiak” presupozojmë institucionin më vete. Kështu, gjykojeni vetë dhe vendoseni

Anastas Angjeli – Atëherë, propozoj që ta diskutojnë edhe njëherë ekspertët tanë me ekspertët e Komisionit të Ligjeve, në qoftë se ka ndonjë shkelje ligjore le ta heqim. Por duke qenë se janë dy institucione të ndryshme në lidhje me rregullat e taksave, të dyja kanë dhe kompetenca të ndryshme të këshillit bashkiak dhe të bashkisë, herë pas here edhe mund të mbetet.

Prandaj hedhim në votim nenin 2, kështu siç është me sugjerimin që ekspertët të bëjnë verifikimin përkatës. Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet neni 2 sipas propozimit të bërë dhe komenteve që thamë.

Neni 3. Në nenin 21 “Rregullat e përbashkëta të taksës mbi pasurinë e paluajtshme” të bëhen këto ndryshime:

Në pikën 2/1 fjalët, në anekset 2 dhe 2/1 zëvendësohen me fjalët “në anekset 1 dhe 2 në pikën 3”, fjalët “të parashikuara në aneksin 2”, zëvendësohen me “të parashikuara në aneksin 1”.

A ka sugjerime? A ka vërejtje?

Blerina Gjylameti – Jo.

Anastas Angjeli – Nuk ka. A ka pyetje? Diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e nenit 3.

Kush është dakord me nenin 3? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 3.

Neni 4. Në pikën 6 të nenit 22 për taksat mbi ndërtesat bëhen këto ndryshime: 1) shkronja “ë” ndryshohet si më poshtë vijon: “ë” ndërtesat e banimit të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie, pension institucional, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë ose me persona në ngarkim të tyre që janë të paaftë në punë”.

2) Në shkronjën “g” në fund të fjalisë shtohen fjalët “të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse”.

A ka sugjerime për nenin 4?

Blerina Gjylameti – Ka një propozim nga Komisioni i Ligjeve që shkronja “ë” të ndryshohet dhe të riformulohet si më poshtë:

“Ndërtesat e banimit të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët, që përfitojnë vetëm pension pleqërie, pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë ose edhe me persona në ngarkim të tyre që janë të paaftë për punë”.

Anastas Angjeli – Pra shtohen fjalët “vetëm pension”.

Blerina Gjylameti – Pra, ka një riformulim.

Anastas Angjeli – A ka ndonjë koment tjetër?

Blerina Gjylameti – Jo.

Anastas Angjeli – Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord me vërejtjet që ka bërë Komisioni i Ligjeve?

Miratohet me vërejtjen e Komisionit të Ligjeve.

Neni 5. Shkronja “c” e nenit 22/4 “Përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë”, ndryshon si më poshtë vijon:

“Vlerëson vlerën e pasurisë së paluajtshme për ndërtesat me metodat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe detyrimin për taksën e pasurisë së ndërtesës”. A ka vërejtje?

Blerina Gjylameti – Jo.

Anastas Angjeli – A ka pyetje? Nuk ka.

Hedhim në votim neni 5. Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet neni 5.

Neni 6. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 23 “Taksa mbi tokën bujqësore”, fjalët “në aneksin 2” zëvendësohen me fjalët “në aneksin 1”. A ka vërejtje?

Blerina Gjylameti – Jo.

Anastas Angjeli – A ka ndonjë koment? Nuk ka.

Votojmë nenin 6.

Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet neni 6.

Neni 7. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 23/1 “Taksa mbi truallin”, fjalët “në aneksin 2/1” zëvendësohen me fjalët “në aneksin 2”. A ka vërejtje?

Blerina Gjylameti – Jo.

Anastas Angjeli – A ka pyetje? Nuk ka.

Kalojmë në votimin e nenit 7. Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet neni 7.

Kalojmë te neni 8. Në nenin 34 “Vërtetimi i pronësisë për efekte të detyrimit për pagimin e taksave”, në fjalinë e tretë, fjala “bashkitë” zëvendësohet me fjalët “bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë”. A ka vërejtje?

Blerina Gjylameti – Jo.

Anastas Angjeli – Kalojmë në votim të nenit 8.

Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet neni 8 sipas projektit.

Neni 9. Në nenin 27 “Taksa e ndikimit të infrastrukturës”, të bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1) Në fjalinë e parë pas pikës 1, pas fjalëve “e investimit të ri që kërkohet të kryhet” shtohen fjalët “sipas preventivit.

Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

2) Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4% deri në 8% të çmimit të shitjes për metër katror. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi të kushtëzuara për të ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo biznesi. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave.

Pika 3 ndryshon si më poshtë vijon:

3) Në rast të ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.

a) Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë, bujqësisë dhe ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetiak nga individët, të ndërtuara nga vetë individët me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3% të vlerës së investimit. Ndërsa për Bashkinë e Tiranës është 2 deri në 4 % të saj.

b) Për projektet e infrastrukturës për ndërtimin e rrugëve kombëtare të porteve dhe të aeroporteve, të tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji përfshirë makineri dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit të infrastrukturës së ndërtimeve të reja është 0,1% e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është e përfshirë në preventivin e investimeve.

c) Për ndërtesa që janë në proces legalizimi taksa e ndikimit të infrastrukturës së ndërtimeve të reja është 0,5% e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi është vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesit.

A ka vërejtjeje apo sugjerime?

Blerina Gjylameti – Ka një propozim të Komisionit të Ligjeve, që në fund të pikës 2 të këtij neni parashikohet që udhëzimi do të jetë akti i Këshillit të Ministrave që do të përcaktojë çmimin e shitjes për metër katror. Komenti është që kjo pikë është e parashikuar në variantin ekzistues të ligjit dhe nuk ndryshon, prandaj është e kotë që ta vendosim.

Ilir Xhangolli – Kur e kaluam herën e parë projektbuxhetin bëmë një propozim për taksën e infrastrukturës në zonat malore dhe nëse ka mundësi ta bëjmë 0, sepse ne duhet t'i stimulojmë që ata të jetojnë në fshat ose ta lëmë nga 0 në 3 dhe pastaj t'ia lëmë në kompetencë këshillit bashkiak.

Arben Ahmetaj – Pra, ju propozoni që nga 1 në 3, të bëhet 0 deri në 3?

Ilir Xhangolli – Zonat malore i ndërtojnë shtëpitë vetë dhe t'ua lëmë taksën 0, sepse nuk kanë mundësi ta paguajnë.

Arben Ahmetaj – Do të kemi një vështirësi të definimit të zonave.

Ilir Xhangolli – T'ia lëmë në dorë këshillit bashkiak për zonat malore.

(Diskutime pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Vazhdojmë mbledhjen. A ka komente? Nuk ka.

Zoti Ministër, a keni ndonjë koment për sugjerimin e zotit Xhangolli?

Arben Ahmetaj – Kam vetëm një merak që do ta diskutoj me Komisionin. Meraku është definimi i zonave malore, dhe e dyta, por kur ka në këto zona malore ndërtime me destinime të tjera, pra jo shtëpi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Ta shkruamë “vetëm për shtëpi banimi” dhe pjesa tjetër të mbetet siç ishte.

Arben Ahmetaj – Për shtëpitë e banimit të jetë nga 0 në 3?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është shumë racional si propozim.

Anastas Angjeli – Kush është dakord që të miratojmë nenin 9 me dy ndryshimet e propozuara. A ka kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet neni 9.

Neni 10. Meqenëse projektet i keni përpara nuk po li lexoj të plotë. Për nenin 10 a ka ndonjë propozim?

Blerina Gjylameti – Nuk ka propozime.

Anastas Angjeli – Nuk ka. Kalojmë në votimin e nenit 10.

Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet neni 10 sipas propozimit.

Neni 11. A ka ndonjë ndryshim?

Blerina Gjylameti – Nuk ka ndryshime.

Anastas Angjeli – Hedhim në votim nenin 11.

Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet neni 11.

Neni 12. A ka ndonjë sugjerim?

Deputete – Nuk ka propozime.

Anastas Angjeli – Nuk ka propozime. Hedhim në votim nenin 12. Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet neni 12.

Neni 13. A ka propozime për nenin 13?

Blerina Gjylameti – Nuk ka propozime.

Anastas Angjeli – Hedhim në votim nenin 13. Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet neni 13.

Neni 14. A ka sugjerime?

Blerina Gjylameti – Jo.

Anastas Angjeli – Kalojmë në votimin e nenit 14.

Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet neni 14.

Neni 15.

Blerina Gjylameti – Ka një propozim të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese për ndryshimin e tabelës për klasifikimin sipas bashkive në aneksin 1 të projektligjit. Ju ka ardhur si propozim dhe keni rënë dakord në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, prandaj e kemi futur në propozimet e marra parasysh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një klasifikim të ri për ndryshimin e tabelës sipas bashkive.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni rënë dakord.

Anastas Angjeli – Hidhet në votim neni 15 me propozimin e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese për ndryshimin në tabelë.

Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 16. Ky ligj në fuqi 15 ditë pas votimit në Fletoren Zyrtare.

Hidhet në votim neni 16.

Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet.

Votojmë ligjin në tërësi. Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet ligji në tërësi për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10. 2006, “Për sistemin e taksave vendore të ndryshuar”.

Kalojmë në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”

Neni 1. A ka vërejtje? Zoti Bushati, a keni ndonjë vërejtje për TVSH-në në nenin 1?

Ervin Bushati – Faleminderit!

Ka një propozim që vjen nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese dhe që është riparë edhe nga komisioni ynë, që ka të bëjë me transportin publik. Propozimi është: shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar e cila aplikohet për furnizimin e mjeteve të transportit publik të udhëtarëve...

(Ndërhyrjeje pa mikrofon)

Po, të licencuar të transportit publik, vetëm me motor elektrik 6% për 3 vjet dhe pastaj kalon në 10 % TVSH-ja. Vetëm për ata që janë të licensuar.

Anastas Angjeli – Zoti Ministër, a jeni dakord?

Arben Ahmetaj – Është shumë racional si propozim ...

Anastas Angjeli - Faleminderit, zoti Ministër!

E hedhim në votim nenin 1, me propozimin e ndryshuar nga Komisioni i Veprimtarive Prodhuese.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 1 me ndryshimin.

Ervin Bushati – Jo, ka edhe një pikë brenda nenit 1, që është pika 6.

Anastas Angjeli – Pse e fillove nga neni 7 propozimin, e filloje sipas radhës që e ke të shkruar, meqenëse ke edhe pikën 6.

Ervin Bushati – Po, sepse ky ka qenë propozimi i ministrisë, kurse pikën tjetër e kemi shtuar ne. Kështu që e para ishte në diskutim.

Anastas Angjeli – Na i thuaj, sepse nuk ka rëndësi.

Ervin Bushati – Pika 6 Komisioni për Ekonominë dhe Financat propozon që pas pikës 7 të shtohet pika 8, me këtë përmbajtje: “Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e librit, në vlerën 6%”.

Anastas Angjeli – Libri vendoset këtu?

Ervin Bushati – Po.

Anastas Angjeli – Atëherë, e hedhim edhe një herë në votim nenin 1, me të dyja ndryshimet.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 1 me ndryshimin.

Ju lutem, mbajini shënim të dyja!

Neni 2.

A keni vërejtje, zoti Bushati?

Ervin Bushati – Jo, nuk kam.

Arben Ahmetaj – A mund të bëj një koment për nenin?

Anastas Angjeli – Për nenin 2?

Arben Ahmetaj – Po, me shtesën që bëri zoti Bushati për librin.

Anastas Angjeli – Ishte për nenin 1.

Zoti Ministër, jemi te neni 2.

Arben Ahmetaj – Nëse mundem, dua t’ju kujtoj diçka te neni 1.

Anastas Angjeli – Ne e votuam nenin 1, a ka ndonjë gjë që ndryshon në votim.

Arben Ahmetaj – Jo, nuk ndryshon, por ju kujtoj se do të hiqet te përjashtimi. Të mos harrojmë që ta reflektojmë, se ka qenë furnizimi i përjashtuar.

Anastas Angjeli – Jo, edhe në qoftë se harrojmë ne, ju jeni këtu dhe do të na e kujtoni. Vazhdojmë me nenin 2.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 2.

Neni 3.

Ervin Bushati - Neni 3, për efekt të teknikës legjislative, duhet të shprehet: “Përjashtimi për disa veprimtari të tjera”, germa “j” ndryshohet me këtë përmbajtje. “Furnizimi i shërbimeve shtypshkronja për gazeta, furnizimi i gazeta është...”

Anastas Angjeli – Pra, atë që thamë, do ta vendosim këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ervin Bushati – Domethënë, ajo që bëme në nenin 1, pika 8, do të thuhet:... **Anastas Angjeli** – Po, pra e vendosim te neni 3.

Atëherë, me ndryshimin e bërë, votojmë nenin 3.

Fran Brahimi – Kam një koment me ministrin, te neni 3 përfshihen edhe masonët? Çfarë do të bëhet me nënkontraktuesit?

Anastas Angjeli – Pika 1 e pikës 2?

Fran Brahimi – Po te germa “k”.

Anastas Angjeli – Pra, atë që diskutuam pak më parë.

Fran Brahimi – Kryerja nga kontraktorët e furnizimit të shërbimeve...

Ervin Bushati – Ky është neni 4.

Anastas Angjeli – Tani jemi te neni 3, kurse ti po flet për nenin 4.

Neni 3.

Fran Brahimi - Neni 3.

Pse thua neni 4 “Shërbimet e përpunimit të mallrave joshqiptare të destinuar për t’u rieksporuar’, janë fasonët.

Anastas Angjeli - E ke për pikën 1 të pikës 2?

Fran Brahimi – Po, për pikën 2, germa “k”.

Anastas Angjeli – Pika 1 e pikës 2 e nenit 3.

Të lutem, zoti Bushati, ndiqe, si relator që je!

Zoti Ministër, ka një propozim për nenin 3, pika 2,/1 “Kryerja nga nënkontraktorët e furnizimit të shërbimeve...”.

Zotëri, propozimi juaj.

Fran Brahimi – Para propozimit dua të bëj një koment, bëhet fjalë për fasonët, por për nënkontraktuesit, si do të veprohet, ndryshe mund të bëj një propozim, që më ka ardhur për t'u bërë.

Anastas Angjeli - Thuaj propozimin që të dëgjojmë.

Fran Brahimi – “Kryerja nga nënkontraktorët e furnizimit të shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare të destinuara për t'u rieksporuar për personat e tatueshëm, të autorizuar mbi bazën e disa dispozitave, që parashikon Kodi Doganor për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv. Ministri përgjegjës për Financat përcakton, me udhëzim, dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e përjashtimit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo duhet fshirë dhe pas germës “b”, të shtohet germa “c”: “Kryerja nga nënkontraktorët e furnizimit të shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare të destinuara për t'u rieksporuar, për personat e tatueshëm, të autorizuar mbi bazën e dispozitave që parashikon Kodi Doganor për operacionin nën regjimin e përpunimit aktiv. Ministri përgjegjës për Financat përcakton, me udhëzim, procedurën specifike për të siguruar trajtimin me shkallën tatimore të TVSH-së 0% për këto furnizime që trajtohen si eksporte”.

Anastas Angjeli – Më falni, me gjithë tolerancën time, dhe e mirëkuptoj propozimin, duhej të ishte bërë më parë. A e keni propozimin?

Blerina Gjylameti – Zoti Bushati, e keni te neni 4/1 këtë propozim.

Anastas Angjeli – Në qoftë se është te neni 4/1, ju lutem, më lejoni që të përfundoj votimin e nenit 3, ashtu siç kishim nisur procedurën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti do që të miratohet, apo do ku ta vendosim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E ka gjetur vendin ai, ma lër mua që e drejtoj, mbledhjen ta gjej vendin.

Kemi votuar nenin 3, me propozimet konkrete.

Edhe një herë neni 3.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 3.

Kalojmë te neni 4.

Në fund, kur ekspertët të bëjnë përfundimin, ta vendosin atje ku duhet propozimin tuaj, në qoftë se ka ndonjë gjë.

Ervin Bushati – Neni 4 germa “ç” riformulohet si vijon: “Furnizimi i shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare, të destinuara për t’u rieksporuar nga personat e tatueshëm të autorizuar dhe nënkontraktorët e tyre, mbi bazën e dispozitave që parashikon Kodi Doganor për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv. Ministri përgjegjës për Financat përcakton, me udhëzim, dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e përjashtimit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Meqenëse ka një propozim, tani Niko, nuk kuptuat përmbajtjen, apo vendin ku do të vendoset?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E rëndësishme është që të kuptojmë përmbajtjen. Çfarë keni për përmbajtjen?

Ervin Bushati - Në nenin 57 “Eksportet”, germa “ç” riformulohet: “Furnizimi i shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare të destinuara për t’u rieksporuar nga personat e tatueshëm të autorizuar dhe nënkontraktorët e tyre, mbi bazën e dispozitave që parashikon Kodi Doganor për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv. Ministri përgjegjës për Financat përcakton, me udhëzim, dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e përjashtimit”.

Arben Ahmetaj – Kemi një diskutim, që nuk kemi rënë dakord.

Ju kërkoni, që atë që ne kemi përjashtuar ta bënim me zero, apo jo? Ky është propozimi?!

Anastas Angjeli – Ajo nuk lihet në dorë të ministrit.

Ju, propozuesit, a e keni të qartë se çfarë propozoni, apo nuk e keni të qartë?

Pyetja që bëhet është: a është përjashtim, apo është zero?

Ervin Bushati – Shtohet përcaktimi nga mbajtësi i autorizimit dhe nënkontraktorët. Domethënë, edhe nënkontraktorët janë pjesë e zinxhirit. Kjo është e gjitha.

Arben Ahmetaj – Nënkontraktori nuk reflekton fare në doganë si eksportues. Nënkontraktori nuk e reflekton, nënkontraktori nuk eksporton, pra nënkontraktori punon për kontraktin.

Ervin Bushati – Shqetësimi i tyre ka qenë se, meqenëse janë hallkë e zinxhirit dhe të gjitha materialet që mund të marrin apo vlerën e punës që kanë, të mund t’ia kalojnë edhe kontraktin. Kjo është e gjitha.

Arben Ahmetaj – Ne sot e kemi me TVSH dhe ky problem ...

Anastas Angjeli – Në qoftë se te ligji i TVSH-së, në nenin 57, është zero, apo jo?

Arben Ahmetaj – Siç është sot...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne kemi sjellë përjashtimin e nënkontraktorëve për t'i lehtësuar në procedurën e rimbursimit. Pra, ata që lehtësohen janë eksportuesit që deklarohen në eksport, në doganë. Kjo është e gjithë historia. Kemi thjeshtuar hallkën dhe i kemi përjashtuar.

Tani ka ardhur shqetësimi që e sollët ju, që ka disa operacione, disa lloj nënkontraktorësh, të cilët nuk kanë vetëm punë, pra kanë përtej punës, kanë materiale dhe procese teknologjike. Ne kemi bërë një sugjerim tonin, që në definicion të shtojmë, pra t'i veçojmë këta nënkontraktorë, që këta nënkontraktorë të mos ta kenë këtë problem që ju i referoheni nga përjashtimi. Nëpërmjet kësaj shtese që sugjerojmë ne i zgjidhim të dyja.

Së pari, i lehtësojmë në procedurën e rimbursimit të gjithë ata nënkontraktorë, që nuk e kanë këtë problem dhe nuk e kanë këtë nevojë, së dyti, dhe furnizojmë me logjikë rimbursimi të drejtpërdrejtë nënkontraktorët që janë specifikë, që kanë edhe proces teknologjikë. Nëse doni ua vëmë në dispozicion këtë...

Ervin Bushati – Jo, i rakordojmë në fund.

Arben Ahmetaj – Në rregull, i rakordojmë në fund.

Anastas Angjeli – Votojmë nenin 4, me propozimin e bërë, por që kërkohet të bëhet një rakordim midis ekspertëve dhe ekspertëve tanë.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 4.

Ervin Bushati – Kemi nenin 4/2.

Anastas Angjeli – Keni propozim të ri?

Ervin Bushati – Po.

Pas nenit 62, shtohet neni 62/1, me këtë përmbajtje: “Furnizimi i inputeve bujqësore”. Trajtohet si furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja furnizimi i mallrave të mëposhtme: plehra kimike dhe pesticide me përjashtim të hormoneve të klasifikuara në kodet 29, 37, NKM, në njësi jo më pak se 10 kilogramë”.

b. “Lëndëve ushqyese të kafshëve me përjashtim të lëndëve ushqyese të destinuara për përdorim të qenve, maceve, zogjve të kafazit ose kafshëve të tjera shtëpiake”.

c “Farave, fidanëve frutorë, bulbet e bimëve, tuberet, rrënjët tuberoze, zhardhokët, kurorat dhe rizomat, të cilat përdoren vetëm për prodhimin e produkteve ushqimore”.

Së dyti, lista e inputeve bujqësore përcaktohet, sipas aneksit 4, bashkëlidhur këtij ligji. Ky ndryshim do të reflektohet në nenin 70, germa “b”, pas referencës ligjore në nenin 57/61, shtohen nenet 62/1 dhe 62/2”. Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor ulet nga 20%, në 10%.

Arben Ahmetaj – Kemi rënë dakord për 6%.

Ervin Bushati – Po, më falni për 6%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – A keni diçka tjetër? Nuk kemi.

Pas tërheqjes së zotit Bushati, a mund të na sqaroni, zoti Ministër!

Arben Ahmetaj – Sugjerimi im është ky, që ta pozicionojmë, pra jemi dakord me logjikën që tha. Ju keni bërë një propozim, keni bërë propozimin e inputeve zero ose përjashtim. Pra, jemi të hapur për këtë gjë këtu.

(ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Dakord, do t'i rimbursojë buxheti i shtetit edhe ato që nuk i kanë, por nuk ka rëndësi. Domethënë, Kryeministri dhe ne që ndjekim logjikën e tij kemi reflektuar dhe nga 20 përqindëshi po i përjashtojmë ose po i bëjmë zero. Për këtë duhet të diskutojmë dhe jemi të hapur. Në qoftë se do ta bëjmë zero, duhet pozicionuar diku tjetër, kështu që sugjeroj që specialistët tuaj të ulen me Nikon dhe me drejtorinë e fiskut që ta formatojnë.

Ervin Bushati – Dua të shtoj diçka. Te neni sugjeroj të shtohet një pikë për shërbimin veterinar. Kjo është për diskutim, ju lutem më dëgjoni deri në fund! Furnizimi i shërbimeve veterinare, me përjashtim të shërbimeve ndaj qenve, maceve, zogjve të kafazeve dhe kafshëve shtëpiake, është furnizim i tatueshëm dhe ky të përjashtohet në TVSH. Domethënë, të gjithë veterinerët që bëjnë vizita, kur shkruajnë faturat, duhet të përjashtohen njësoj si pjesa e inputeve. Kjo ishte një kërkesë që na u bë dje nga...

Anastas Angjeli – Zoti Bushati, faleminderit për propozimin e qenve dhe të maceve, por, para se të kalojmë atje, ne duhet të diskutojmë këtë propozim që thamë.

Ervin Bushati – E thashë meqë do të votohen bashkë.

Anastas Angjeli – Më fal, kemi TVSH-në për inputet, variantin zero, me përjashtim të 0 me 10 apo 0 me 6...

Arben Ahmetaj – Zoti Anastas, është vendosur 0 me 6.

Anastas Angjeli – Dhe nuk kemi probleme të tjera.

Ervin Bushati – Përjashtim me 6.

Arben Ahmetaj – Përjashtim apo zero, unë sugjeroj përjashtimin, por ju si komision mund të bëni propozimin tuaj dhe unë jam i hapur.

Anastas Angjeli – Ne kemi bërë një diskutim për këtë çështje dhe kemi rënë dakord.

Ervin Bushati – Propozimi është përjashtim.

Arben Ahmetaj – Si të doni ju! Bie dakord me përjashtimin, ashtu si ju.

Ervin Bushati – Përjashtim.

Anastas Angjeli – A e pe mirë, a e lexove?

Ervin Bushati – Po, përjashtim

Anastas Angjeli – Zoti Ministër, çfarë lidhje keni me këtë pikën për veterinerët?

Arben Ahmetaj- Për veterinerët ka një gjë.

Së pari, diskriminimi që u bëni kafshëve nuk është i drejtë.

Së dyti..

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Ju lutem, mbani qetësi, sepse është mbledhje e gjatë dhe problemet duhet të sqarohen.

Arben Ahmetaj – Së dyti, shërbimi veterinar praktikisht është në zinxhirin e biznesit, nuk është si mjeku me shëndetin e njerëzve, por është në procesin e biznesit dhe, praktikisht, faturimi me TVSH është gjëja më normale, sepse pastaj del noteri dhe thotë pse nuk më përjashton edhe mua.

Ervin Bushati – Kur e nisëm këtë iniciativë, kishte të bënte me bujqësinë dhe blegtorinë. Domethënë, të ndihmojmë pjesën e ekonomisë rurale dhe nuk duam të hapim një vrimë në buxhetin e shtetit, pastaj për gjithë industrinë, që është luksi i mbajtjes së kafshëve.

Së dyti, shërbimi veterinar është i lidhur, nuk mund të thuhet tamam inpute. Dje ne kishim shoqatën e veterinerëve dhe ata kërkuan që për sa kohë kjo ka të bëjë me shërbimet në fshat, që ndihmojnë pjesën blegtorale, të industrisë bujqësore... sepse te inputet do të futen edhe te shërbimi veterinar.

Arben Ahmetaj – Dakord, të përjashtohet shërbimi veterinar, por duhet të rakordohet kjo, sepse këto janë në procesin e sipërmarrjes dhe të biznesit.

Anastas Angjeli - Nëse e miratojmë nuk mund të japim argumente pse nuk është gjë e duhur.

Arben Ahmetaj – Zoti Anastas, unë dua ta them mendimin tim.

Anastas Angjeli –Dakord, por...

Ervin Bushati – Ose bie, ose qëndron. Biznes janë edhe inputet, sepse ai për biznes i sjell.

Anastas Angjeli - Atëherë, prevalon logjika për veterinarinë. Hedhim në votim nenin 4. Nuk ka komente.

Votojmë propozimin e parë. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Neni 1, përjashtimi për inputet.

1 votë kundër.

Propozimi i dytë, shërbimi veterinar. Kush është kundër? Kush është dakord? Shënojeni që zoti Braçe është kundër.

Miratohet.

Neni 5, “Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar të vitit 2019”. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Kalojmë te miratimi i ligjit në tërësi “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

1 votë kundër, zoti Braçe.

Kalojmë në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar”.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 1?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli - Neni 1. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 2?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli - Neni 2. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 3?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli-Neni 3. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 4?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 4. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 5?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 5. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 6?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 6. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 7?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 7. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 8?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 8. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 9?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 9. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 10?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 10. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 11?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 11. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 12?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 12. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 13?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 13. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 14?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 14. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 15?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 15. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 16?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 16. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 17?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 17. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 18?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 18. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 19?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 19. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Kalojmë te votimi në tërësi. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Kalojmë te projektligji “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 1?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 1. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 2?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 2. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 3?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 3. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 4?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 4. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 5?

Blerina Gjylameti – Po, ka një ndryshim në fund të nenit 27/1 kemi dy pika për të ndryshuar. Në fund të nenit 27/1 paragrafi 1, shtohet fjalia “Vendosja e kufirit për aplikimin e skemës së re të taksimit të fitimeve kapitale nga ndryshimi i pronësisë.

Anastas Angjeli- Te cila pikë shtohet?

Blerina Gjylameti – Paragrafi 1, neni 27/1 “Ndryshimi i pronësisë”. Paragrafi 1 aplikohet në rastet kur personi juridik për tri vitet paraardhëse ka realizuar një mesatare qarkullimi prej 500 milionë lekësh.

Anastas Angjeli – Zoti Ministër, a mund të na jepni mendimin tuaj?

Arben Ahmetaj – Shkon në të njëjtën logjikë me OECD-në.

Anastas Angjeli – Dakord. A ka pyetje apo vërejtje të tjera?

Blerina Gjylameti – Jo.

Anastas Angjeli – Atëherë, hedhim në votim nenin 5 me ndryshimet e propozuara. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Zonja Gjylameti, a ka ndonjë propozim për nenin 6?

Blerina Gjylameti – Jo, nuk ka.

Anastas Angjeli- Neni 6. Kush është kundër? Abstenim? Dakord?

Miratohet.

Neni 7.

A keni ndonjë propozim?

Blerina Gjylameti – Jo.

Anastas Angjeli – Votojmë nenin 7. Kundër? Abstenim? Kush është dakord?

(Reagim pa mikrofon)

Blerina Gjylameti – Neni 7 është për ndryshimin e dividendit nga 15% në 8%.

Anastas Angjeli – Zoti Braçe është kundër.

Miratohet neni 7.

Neni 8.

Blerina Gjylameti – Nuk kemi asnjë propozim, por, para se të kalojmë te neni 9, kemi propozim për një shtesë në fund të nenit 24, që nuk është te ligji i ndryshuar.

Anastas Angjeli – Është nen i ri?

Blerina Gjylameti – Po.

Anastas Angjeli – Atëherë, të mbarojnë me nenin përkatës.

Hedhim në votë nenin 8. Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet.

Urdhëroni!

Blerina Gjylameti – Në fund të nenit 24, te “Borxhet e këqija”, të shtohet pika C me këtë përmbajtje: “Në rast se pasuria e luajtshme ose e paluajtshme, që siguron kredinë, ekzekutohet para afateve të përcaktuara në pikat A dhe B më lart, provizionet e mëparshme, të njohura si shpenzime të zbritshme, do të njihen si të tilla”.

Anastas Angjeli – Zoti Ministër?

Arben Ahmetaj – Dakord, se sqaron më mirë edhe procedurën aktuale.

Kështu, faleminderit!

Anastas Angjeli – Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord që para nenit 9 të shtohet një nen i ri me përmbajtjen e mësipërme?

Blerina Gjylameti – Që i referohet nenit 24 të ligjit.

Anastas Angjeli – Ekspertët ta marrin shënimin dhe ta evidentojnë.

Miratohet neni 8.

Neni 9. A keni ndonjë propozim?

Blerina Gjylameti – Asnjë.

Anastas Angjeli – Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet neni 9.

Neni 10. Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet neni 10.

E votojmë ligjin në tërësi. Kush është kundër? 1 votë kundër. Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet.

Kalojmë te ligji i fundit “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, ti ndryshuar”.

Neni 1. A keni ndonjë propozim, zoti Bushati? Nuk keni.

Kush është kundër? 1 votë kundër. Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet.

Neni 2: “Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare. Hyn në fuqi më 1 janar 2019”. Kush është kundër? Abstenim? Kush është dakord?

Miratohet.

E votojmë ligjin në tërësi. Kundër? 1 votë kundër, zoti Braçe. Abstenim? Kush është dakord me ligjin në tërësi?

Miratohet.

Me këtë ligj përfundoi edhe miratimi i projektligjeve të paketës fiskale, që shoqërojnë projektbuxhetin e vitit 2019.

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 27.11.2018, ora 16:30

Drejton mbledhjen:

Anastas Angjeli – sekretar i Komisionit

Rendi i ditës:

2. Shqyrtimi i raporteve të komisioneve të Kuvendit për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”.
3. Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2019”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj dhe Reme Lala.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Gelardina Prodani – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
Mimoza Dhembli – Drejtoreshë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Gentian Opre – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Fran Brahimi – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Nikolla Lera – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Enkeleda Bako – Përgjegjëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Arber Lleshi – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Anastas Angjeli – Rifillon mbledhja.

Para se të fillojmë mbledhjen, duhet të vendosim procedurën që do të ndjekim. Gjatë gjithë këtij muaji kemi diskutuar dhe e kemi miratuar në parim projektbuxhetin. Komisionet parlamentare kanë diskutuar dhe kanë sjellë propozimet e tyre për ndryshimet në projektbuxhetin e vitit 2019. Natyrisht, unë do t'i paraqes një pjesë të mirë të propozimeve të tyre, të cilat Komisioni i Ekonomisë i ka shqyrtuar dhe i ka marrë në konsideratë, pavarësisht se sa do të miratohen, duke gjetur mirëkuptim me ministrin dhe me stafin e tij, që është këtu. Ne, të dy relatorët, i kemi konsideruar amendamentet dhe të gjitha ndryshimet ia kemi propozuar Komisionit të Ekonomisë dhe do të miratohen si ndryshime të komisionit, pra do të reflektohen në secilin nen shumë që ndikojnë. Kështu që për secilin nen, do të themi miratohet me ndikimin që do të ketë shuma e shpenzimit apo e të ardhurave që duhet reflektuar për të arritur balancat përkatëse në secilin nen. A jemi dakord? Pas përfundimit të mbledhjes do të bëhet relacioni, ku do të jenë amendamentet e komisionit për secilin nen “ishte dhe “propozohet të ndryshojë” dhe shumë përkatëse. Kjo është procedura e Rregullores.

Sig ju thashë, Komisioni i Ekonomisë në një mbledhje të posaçme i ka shqyrtuar një për një të gjitha propozimet. Unë do të filloj t'i them në mënyrë të përmblendhur edhe nevojat konkrete, në shumë konkrete dhe arsyetimin për secilin.

Kuvendi i Shqipërisë, Byroja e Kuvendit, ka paraqitur kërkesën për shtesë shpenzimesh të Kuvendit në shumën 176 milionë lekë, të cilat kryesisht lidhen me rastin e 100-vjetorit të parlamentit shqiptar. Janë një sërë veprimtarish dhe aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë vitit të ardhshëm për të kremtuar festimin e 100-vjetorit të parlamentit shqiptar.

Së dyti, ka një kërkesë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, e cila është një shumë minimale, 16,5 milionë lekë, për rritjen e numrit të punonjësve në funksion të përsosjes së auditimit të performancës, të auditimeve financiare dhe atë të IT-së, të cilat janë tri llojet e auditimit që kanë filluar të aplikohen vetëm 3 vjetët e fundit, pas miratimit të ligjit të ri këtu.

Komisioni i Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka marrë në analizë të gjitha institucionet e tij, Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Përgjithshme, Zyrën e Administrimit Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, Avokatin e Popullit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Shkollën e Magjistraturës, Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (janë shumë përkatëse, të cilave do t'u referohen në fund në tabelat përkatëse), Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili ka kërkuar një shtesë për 3 punonjës, por kryesisht është për një investim, pra për rikonstruksionin e katit të tretë, që është një ambient për tri institucione

të pavarura dhe është i papërfunduar. Janë edhe disa autoritete e komisione të tjera të pavarura. Në të njëjtën kohë, siç do t'ju deklaroj, janë disa probleme që kanë ministrinë e linjë.

Së pari, bazuar edhe në argumentet që ka sjellë Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, është Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Do t'ju lutem që të keni vëmendjen!

Komisioni ka propozuar të rialokojë shpenzimet korrente si më poshtë: në programin “Zhvillimi rural”, 04 250, pakësohen shpenzimet korrente 100 milionë lekë dhe shtohen 100 milionë lekë në artikullin “Mallra e shërbime”; pakësohen 200 milionë lekë në artikullin “Transferta për buxhetet familjare dhe individët” dhe në programin “Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit” shtohen shpenzimet korrente, në artikullin 602, 100 milionë lekë. Pra, kemi të bëjmë me një rialokim të brendshëm. Në programin e menaxhimit të infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes të shtohen shpenzimet kapitale me 1948 milionë lekë, nga të cilat financim i huaj 1478, financim i brendshëm 470 milionë lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ministria e Bujqësisë. Po flas për infrastrukturën e kullimit dhe të ujitjes.

Këtu kërkohet shtesë. E ka kërkuar Komisioni i Veprimtarive Prodhuese.

Komisioni i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë, Ministria e Shëndetësisë, për shërbimin e emergjencës në disa bashki kërkon shtesa të shpenzimeve në 10 milionë lekë.

Komisioni i Sigurisë ka rialokim në Shërbimin Informativ, ka propozim të Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Ministria e Mbrojtjes shtesën për anëtarësimin në NATO, detyrimet që kemi dhe në të njëjtën kohë për emergjencat civile.

Ka Drejtoria e Kufirit dhe Emigracionit dhe Garda e Republikës; ka Komisioni për Edukimin; Drejtoria e Përgjithshme e RTSH-së kërkon të shtohen shpenzimet për investime në 490 milionë lekë, sipas zërave të përkatës. Pastaj janë institucionet e tjera, si Qendra Kinematografike Kombëtare - 13 milionë, Agjencia Telegrafike – 5 milionë. Për Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve në të njëjtën kohë, komisioni propozon të shtohen shpenzimet korrente në 25 milionë lekë për të kompensuar mungesën e të ardhurave nga lojërat e fatit dhe këto destinohen për zhvillimin e sportit, pa atë të Federatës së Futbollit.

Ka një rialokim për klubet sportive shumësportëshe, “Partizani” dhe “Studenti”.

Komisioni i Jashtëm ka një rialokim të brendshëm dhe një shtesë, kërkesë për 16 milionë lekë shpenzime korrente apo kapitale, nuk e ka përcaktuar, në 8 milionë lekë në programin

Planifikim Menaxhim dhe Administrim dhe 8 milionë lekë në mbështetje institucionale për procesin e integritetit.

Në të njëjtën kohë komisioni ka mbështetur edhe propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën për rritjen e shpenzimeve të shërbimit të diasporës me shumën nga 83 milionë lekë në 174 milionë lekë, që është rreth 80 milionë lekë për Agjencinë Kombëtare, për Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës dhe për Qendrën e Botimeve për Diasporën.

Autoriteti i Konkurrencës ka nevojë për një investim të vogël.

Këto janë propozimet, të cilat më konkretisht, në tabelën që do të paraqes, do t'ua vëmë në dispozicion. Ju lutem t'i marrim një nga një me qëllim që të arrijmë në diskutim përfundimtar.

Kuvendi i Shqipërisë, shtesa 176.

Kush është dakord?

Zoti Ministër, komenti juaj!

Arben Ahmetaj – Burimin do ta diskutojmë me specialistët dhe do ta riallokojmë, sepse shtesë në shpenzime nuk ka.

Anastas Angjeli – Zoti Ministër,

Në fund do të shikojmë çështjen e burimit. Tani të përcaktojmë çështjen e shpenzimeve dhe pastaj përcaktojmë mënyrën e burimit.

Arben Ahmetaj – Dakord.

Anastas Angjeli – Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kërkuar 16,5 milionë.

Arben Ahmetaj – Kam rënë dakord me kryetarin që, përveç 5 apo 6 vetave që ka kërkuar, s'di sa i saktë jam, për pjesën e shtesës nuk ka as arsye, as logjikë. Kështu që jemi dakord me kërkesën e numrit të njerëzve, por jo të fondeve.

Anastas Angjeli – Po si do të punojnë ata pa u paguar?

Arben Ahmetaj – Jo, nuk ka lidhje shifra 16 milionë, se pagat i kanë.

Anastas Angjeli – Se i kanë të ndara, numër punonjësish, një pjesë për pagën, një pjesë për investimet.

Arben Ahmetaj – 6 persona do t'ia japim, të asocuar me pagën.

Anastas Angjeli – Atëherë, 10 milionë i bie, afërsisht?

Arben Ahmetaj – I bie pak më pak, por s'ka rëndësi fare. Shënoje 10 milionë.

Anastas Angjeli – Pra, dakord me 10 milionë.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ministria e Drejtësisë?

Arben Ahmetaj – Është mbyllur në qeveri diskutimi me Ministrinë e Drejtësisë.

Anastas Angjeli – Prokuroria e Përgjithshme ka kërkuar numër punonjësish shtesë.

Arben Ahmetaj – Numrat i kemi shtuar, fondet i kanë.

Anastas Angjeli – Zyra e Administrimit të Buxhtit të Gjyqësorit kërkon 10 veta.

Arben Ahmetaj – E kemi mbyllur diskutimin për Gjyqësorin edhe me Kryeministrin. Do të jetë sa ç'e kanë.

Anastas Angjeli – Avokati i Popullit.

Arben Ahmetaj – Nuk kemi rënë dakord.

Anastas Angjeli – Kemi rënë dakord që të shtohet për ILDKPI-në 4 milionë.

Arben Ahmetaj – Po, kemi rënë dakord.

Anastas Angjeli – Kemi rënë dakord për KQZ-në që shtohet me 27.

Arben Ahmetaj – Jo, nuk kemi rënë dakord.

Fondi i administrimit të zgjedhjeve është i plotë.

Anastas Angjeli – Më duket se kjo ka qenë një shtesë për administrimin e kutive dhe fletëve të votimit...

Arben Ahmetaj – Jo, është rikonstrukcion.

Anastas Angjeli – Po pra, rikonstrukcioni i magazinës ku do të depozitohen kutitë dhe fletët e votimit (me sa jam i informuar).

Arben Ahmetaj – Ta lëmë me pikëpyetje dhe t'i kthehemi më pas sa ta verifikojmë!

Anastas Angjeli – Shkolla e Magjistraturës ka kërkuar një investim prej 5 milionë lekësh.

Arben Ahmetaj – Është blerje fugoni për shkollën.

Po.

Anastas Angjeli – Komisionerët e Shërbimit Civil.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit.

Siç ju thashë, këtu ka dy kërkesa, një për 3 persona dhe një kërkesë për përfundimin e investimit të katit të tretë që është pjesë e tre institucioneve, jo vetëm e këtij, por ky e ka bërë investimin në dy katet e tjera dhe ka mbetur kati sipër i papërfunduar.

18 milionë është shuma e kërkuar.

Arben Ahmetaj – Njerëzit jo, investimin po.

Anastas Angjeli – Dakord. 15.

Autoriteti për të drejtën e informimit kërkon shtim të numrit të punonjësve, 10 veta, investim 23, gjithsej 33.

Arben Ahmetaj – Jo. Nuk kemi rënë dakord.

Anastas Angjeli – Komisioni i Pavarur i Kualifikimit kërkon të shtohet numri i punonjësve me 14.

Arben Ahmetaj – Ne e kemi reflektuar këtë.

Anastas Angjeli – Kolegji i Posaçëm i Apelimit 6 veta, 12,7.

Arben Ahmetaj – E ka të reflektuar.

Anastas Angjeli – Ministria e Bujqësisë. Kemi dy kërkesa.

Një për rialokim.

Arben Ahmetaj – Rialokimi dakord. Për shtesën nuk kemi rënë dakord.

Ka kaluar në qeveri buxheti i Ministrisë së Bujqësisë.

Anastas Angjeli – Në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese ka pasur një diskutim të gjatë për situatën e krijuar nga përmbytjet dhe kërkojnë të bëjnë një shtesë.

Unë e kuptoj se kjo shtesë është e madhe dhe mundësitë e buxhetit unë i kam shumë të qarta. Të mendosh të shtosh 98 milionë sa kishte kërkuar Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, e kuptoj që edhe ju jeni në pozitë, edhe ne jemi në pozitë, por duke parë vështirësitë që janë krijuar nga shirat, gjykoj se mund të diskutojmë për një shtesë vetëm në këtë destinacion për investimet.

Arben Ahmetaj – Jo, zoti Angjeli.

E para, është bërë një kërkesë, por edhe një analizë për t'iu kthyer 160 milionë dollarë që janë harxhuar në 4 vjetët e fundit.

E dyta, çështjet e emergjencave i janë adresuar Ministrisë së Mbrojtjes.

Buxheti i Ministrisë së Bujqësisë ka kaluar në Kuvend, kështu që ky diskutim nuk ...

Anastas Angjeli – Unë jam këtu që të parashtroj kërkesën.

Arben Ahmetaj – Qartë. Ju mirëkuptoj.

Anastas Angjeli – Çështja e emergjencave, që i ka kaluar Ministrisë së Mbrojtjes, nuk ka të bëjë me digat e bujqësisë, as me kanalizimet dhe kullimin. Ka të bëjë me rastet e tjera. Megjithatë jemi këtu për ta diskutuar.

Arben Ahmetaj – Unë jam kundër. Ka kaluar në debat dhe në diskutim të gjatë në qeveri.

Anastas Angjeli – Mbetet në fuqi rialokimi që ka kërkuar Ministria e Bujqësisë.

Arben Ahmetaj – Për rialokimin dakord.

Anastas Angjeli – SHISH-i ka kërkuar rialokim.

Erion Braçe – Natyrisht që këtu mund të thonë çfarë të duan, pa asnjë lloj problemi, se gjithsecili është i lirë për ato që thotë, dhe pa diskutim mban përgjegjësi për ato që thotë. Të paktën, me dy argjinatura që unë i njoh fare mirë, gjendja është katastrofike. Janë goditur në nëntor-dhjetor të vitit që shkoi, argjinaturat janë goditur përsëri në mars-prill të këtij viti. Nuk janë goditur një herë, por janë goditur 4 herë brenda 4 muajve. Ka dalë lumi dhe ka shkuar në argjinaturë.

Dua ta them këtë dhe të mbetet këtu e regjistruar se ditën kur largqoftë të ndodhë diçka, të jeni i bindur që s'do të ndodhën në krahun e Divjakës, por do të ndodhën në krahun e Kavajës dhe të Rogozhinës dhe atë ditë, pa as më të voglin dyshim, unë do të kërkoj përgjegjësi penale për gjithë ata që ishin në dijeni dhe nuk morën masa.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – A ka ndonjë reflektim për çështjen e fondit të për investime për kanalet ujitëse?

Arben Ahmetaj – Jo, nuk ka asnjë reflektim.

Për informacionin tuaj, Ministria e Bujqësisë ka kërkuar te projekti i BB-së për kullimin. Do të shohim disbursimet në vazhdimësi, vitin tjetër, dhe do të vijmë prapë në Kuvend, në kohën e duhur, në rakord me Ministrinë e Bujqësisë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zoti Angjeli, mundem?

Anastas Angjeli – Po.

Erion Braçe – Tashti, unë e kuptoj se gjithsecili është në të drejtën e vet që të thotë çfarë të dojë, por në kushtet kur nuk ka dijeni, mirë është që gjithsecili nga ne të kufizohet, duke filluar nga unë e deri te i fundit.

Projekti i Bankës Botërore është i dedikuar për vepra konkrete, për skema vadtjeje me emër e mbiemër, në territore të caktuara, në volume të caktuara, natyrisht edhe në skema vadtjeje, të cilat shkojnë deri në detaje. Sa u takon argjinaturave, në atë projekt të Bankës Botërore nuk ka absolutisht as edhe një qindarkë. Zero. As edhe një qindarkë.

Kësisoj, projekti i Bankës Botërore nuk shërben dot si burim fondesh, për të zëvendësuar atë që ka kërkuar Komisioni i Veprimtarive Prodhuese atje. Përkundrazi, në kushtet kur tashmë çdo qindarkë e projektit të Bankës Botërore, jo vetëm që është tenderuar, por është kontraktuar dhe ka filluar puna në territor. Nuk ngelet më asgjë për të zëvendësuar atë shumë, për të cilën bëhet fjalë në kërkesën e Komisionin e Veprimtarive Prodhuese.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Braçe!

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

...e këtij problemi nga anëtarët e komisionit? Nuk ka.

Atëherë, Ministria e Shëndetësisë kërkon një rialokim për 10, 8, dhe thamë se do të kemi një shtesë prej 10 milionë për disa bashki, të cilat nuk kanë siguruar shërbim 24-orësh, shtesë e cila është shumë e vogël, për shërbimin e urgjencës. Të shënohet dhe të konsiderohet.

Ju thashë se SHISH ka kërkuar një rialokim të brendshëm të fondeve nga investime në operative, diçka e tillë. Besoj se jeni dakord dhe nuk keni ndonjë kundërshtim për rialokim të brendshëm.

Arben Ahmetaj – Dakord!

Anastas Angjeli – Ka një kërkesë për Drejtorinë e Përgjithshme të emergjencave civile në Ministrinë e Mbrojtjes, që të bëhet edhe një shtesë tjetër, e cila ka të bëjë me urat beli. Nuk e di nëse e keni diskutuar përsëri. Na ka ardhur nga të dy komisionet.

Arben Ahmetaj – Po, e kemi diskutuar edhe me Kryeministrin më pas, pasi kemi miratuar buxhetin në qeveri. Në rialokimin prej 700 milionësh, që do t'i bëjmë Ministrisë së Mbrojtjes për të kapur 1, 25 % të prodhimit të brendshëm bruto, që është edhe kusht për avancimin e përqindjes në raport me GDP-në, në NATO. Unë besoj se do të ndahet në mënyrë të tillë: 200 do të shkojnë te personeli, për akomodimin e rritjes së pagave, 100 do të shkojnë te spitali, ndërsa 400 do të shkojnë te emergjencat civile, te Drejtoria e Emergjencave Civile, ku do të përfshihen edhe urat beli, që ishin një nga shqetësimet e ardhura nga parlamenti, por edhe nga ministrja.

Anastas Angjeli – Po, por në kërkesën që ka bërë Komisioni i Sigurisë, shtesa për Ministrinë e Mbrojtjes ka qenë 1 miliard lekë.

Arben Ahmetaj – Po, e vlerësojmë kërkesën, por kemi rënë dakord me Kryeministrin, brenda mundësive, për 700 milionë lekë. Kemi evidentuar edhe burimet e ku do të shkurtohen dhe të kalojnë te Ministria e Mbrojtjes.

Anastas Angjeli – Garda e Republikës ka bërë tri kërkesa: njëra që lidhet me shpenzimet për personelin, tjetra për investimet. Njëra kërkesë ka qenë shumë e domosdoshme, sepse kishte të bënte me trajtimin ushqimor të punonjësve të gardës. Kërkesa është këtu, e kam të shkruar. Unë mendoj se në tri kërkesat që ka bërë garda, njëra prej tyre është më e rëndësishmja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush e tërhoqi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – ...fondet i kanë marrë edhe për ushqimet, kështu që për gardën nuk biem dakord. Është diskutuar edhe në qeveri në lidhje me këtë punë dhe është sqaruar shumë mirë.

Anastas Angjeli – Mendimi juaj? Kush ka mendim në lidhje me këtë çështje?

Antoneta, ju lutem, mos diskutoni me njëri-tjetrin. A keni ndonjë mendim në lidhje me këtë çështje?

Antoneta Dhima – Në Komisionin e Sigurisë ka qenë i ftuar komandanti i gardës, i cili ka kërkuar vetëm një ndryshim në VKM, sa i takon trajtimin me ushqim, pasi janë përjashtuar, dhe brenda kufirit të fondeve që u juanë akorduar, e përballojnë pagesën. Nuk ka nevojë për fonde shtesë.

Anastas Angjeli – Zoti Braçe?

Erion Braçe – Ja, të dëgjoj ty, meqë je i habitur për çfarë diskutojmë.

Anastas Angjeli – Ja, ta lexoj unë se si e ka shkruar.

Erion Braçe – Po. Mund ta lexoni, zoti Angjeli?

Anastas Angjeli – “Shtesë fondi për trajtimin financiar dhe ushqimor të punonjësve të Gardës së Republikës, që është 150 milionë lekë për njësimin e pagave, dhe 95 milionë lekë si shtesë page për vjetërsinë në punë. Mbështetje me fonde të nevojshme për realizimin e investimeve në infrastrukturë, për financimin e projektit, rikonstruksionin e plotë të ambienteve të jashtme e të brendshme të qendrave...” e me radhë.

Në qoftë se keni diskutime, mund të më thoni. Në qoftë se s’keni, vazhdojmë me...

Po, zoti Braçe.

Erion Braçe – Kam unë diçka. Mendoj se ky komision ka detyrimin e qartë, që të kthejë një përgjigje për punonjësit e gardës së Republikës së Shqipërisë, qoftë për njohjen e vjetërsisë në punën e tyre, qoftë edhe për atë çfarë ata kërkojnë: trajtimin ushqimor.

Në qoftë se për të parën, pra njohjen e vjetërsisë në punën e tyre, është luajtur ping - pong në harkun e shumë viteve, tani ka ardhur momenti të jepet përgjigje, dhe të jepet një përgjigje e qartë me ligj, e natyrisht dhe me buxhetin e shtetit.

Sa për dijeni, punonjësit e Gardës së Republikës nuk ruajnë asnjë nga ne këtu. Zero. Nuk i rrinë pas asnjërit prej nesh këtu. Janë në shërbim të institucioneve kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Kjo është ajo çfarë duhet të kuptojmë. Ka një dallim themelor mes asaj që ata përfaqësojnë sot, me atë që kanë përfaqësuar dje. Dje merrnin pushkën dhe urdhëroheshin për të mbrojtur ata që nuk mbroheshin dhe për të vrarë njerëz.

Sot, me atë reformë që është bërë atje, në Gardën e Republikës, ata janë në mbrojtje të institucioneve kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Thënë këtë, unë mendoj se ky komision ka detyrimin të japë një përgjigje të qartë për punonjësit e Gardës së Republikës, ashtu si për punonjësit e Policisë së Shtetit, ashtu si për punonjësit e Policisë së Burgjeve.

Një shtet dallohet qartë nga mënyra se si trajton këta njerëz, dhe nuk mund ta vërë kurrë në diskutim kompensimin e normës së ushqimit të tyre. Kurrë.

Kjo është ajo çfarë unë mendoj.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Braçe!

Ka koment ndokush tjetër?

Po, zonja Gjylameti!

Blerina Gjylameti – Unë mendoj se duhet të adresohet si problematikë. Ndoshta duhet parë nëse është vetëm çështja e VKM-së. Nga ana tjetër, vjetërsia është një shqetësim, i cili është ngritur që prej disa vitesh. Nuk është shqetësim i sotëm, por shqetësim i disa viteve, që ndërkohë duhet ta adresojmë. Unë nga ana ime, besoj se duhet t'i shikojmë brenda hapësirave që ka buxheti. Brenda mundësive që kemi, kuptohet, sepse ju nuk do të nxirrni dot më shumë nga ç'kemi mundësi, të shikojmë adresimin. Kemi filluar ta adresojmë vitin që shkoi, por nuk arritëm të gjenim zgjidhjen. Mendoj se këtë vit duhet të shikojmë mundësitë për ta adresuar.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Arben Ahmetaj – Ushqimi është i përfshirë.

Anastas Angjeli – Një minutë, ju lutem, me qëllim që të jepni një sqarim më të plotë. Gjithashtu, unë mendoj se te kjo çështja e Drejtorisë së Burgjeve, përveç kësaj të gardës, ka një problem, që mbase edhe ai duhet adresuar. Numri i mjekëve që punojnë në Drejtorinë e Burgjeve është shumë i vogël. ka edhe nju problem që ka dalë: paga e tyre nuk është njësoj si paga e mjekëve të tjerë, por është sa gjysma e tyre. Ata kanë kërkuar që të ketë një barazim të pagës së tyre me pagën e mjekëve të tjerë, për arsye se nuk shkon më asnjë mjek që të punojë në Drejtorinë e Burgjeve. Besoj se ky është një shërbim, i cili, pavarësisht se ata janë persona të privuar nga liria për shkak të krimeve që kanë kryer, kur vjen puna te çështjet shëndetësore duhen parë. Kësisoj, kjo mund të konsiderohet dhe të adresohet, në kuadër të të gjitha adresimeve që do të bëni, bashkë me sugjerimet që kanë deputetët, si dhe mendime të tjera, për të cilat do ta mirëprisja përgjigjen tuaj.

Fjala për ju, zoti Ministër!

Arben Ahmetaj – Për sa i përket ushqimit, është i përfshirë. Do të bëhet ndryshimi në VKM, sepse në një VKM që i referohet trajtimit ushqimor, garda ka qenë e përjashtuar. Do të rifutet në trajtim, sa u takon elementëve të tjerë, do t'i diskutojmë brenda kuadrit të pagave. Për shembull, për Policinë e Burgjeve ne kemi bërë rritje page. Brenda shumës së akorduar, ministri mund të bëjë kategorizimet e duhura. Ne jemi dakord që Ministria e Drejtësisë të bëjë akordimet e duhura në bazë të alokimit buxhetor që ka marrë apo do marrë nëpërmjet këtij buxheti.

Anastas Angjeli – Faleminderit, por nuk mjafton të jeni dakord. Ju takon juve që, në komunikimin që do të bëni në çeljen e fondeve, që ta përfshini këtë.

Arben Ahmetaj – Po, patjetër! Jemi dakord me propozimet e tyre. Nuk kemi problem.

Erion Braçe – Jo, një minutë, zoti Angjeli!

Anastas Angjeli – Po, zoti Braçe!

Erion Braçe – Unë kërkoj kohë deri sa të vijë kërkesa e Komisionit të Sigurisë në lidhje me çështjen e burgjeve...

Anastas Angjeli – E kam unë.

Erion Braçe – E keni ju? Në rregull! Ma jepni pak, ju lutem!

Anastas Angjeli – Për Drejtorinë e Burgjeve?

Erion Braçe – Patjetër!

Anastas Angjeli – “Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve”. Doni ta lexoj?

Erion Braçe – Po, patjetër!

Anastas Angjeli – “Komisioni propozon...”

Erion Braçe – Jo komisioni! Ah, Komisioni i Sigurisë!

Anastas Angjeli – Komisioni i Sigurisë, pra!

Komisioni propozon: Të shtohen 100 punonjës në organikë:

-Për vënien në eficiencë të godinës së re të Institutit të Ekzekutimit të Dënimeve, që është: 313-a, “Jordan Misja”, investim i cili përfundon në fund të vitit 2018. Të shtohen shpenzimet e personelit me 74, 4 milionë lekë, nga të cilat, për vënien në funksionim të Institutit të Ekzekutimit të Dënimeve”, te 313-a, “Jordan Misja”: 36 milionë lekë.

-Për njësimin e pagave të mjekëve të sistemit të burgjeve me ato të mjekëve të sistemit të përgjithshëm shëndetësor: 38 milionë lekë.

Propozim shtesë: të shtohen edhe shpenzime për investime, prej 20 milionë lekësh, për godinat e burgjeve në Rrogozhinë e në Lushnjë.

Ju faleminderit!

Komenti juaj, zoti ministër...

Erion Braçe- Pra, është më shumë sesa çështja e mjekëve dhe është një problematikë akoma më e madhe për një arsye shumë të rëndësishme, sepse nuk shkojnë më mjekët që të punojnë në burg. Pra, është më shumë sesa kaq.

Arben Ahmetaj - Ta diskutojmë me ministren gjatë hapjes së buxhetit dhe patjetër që do ta adresojmë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zoti Angjeli, mua më vjen keq, kjo histori nuk mund të vazhdojë më kështu. Nëse është kryer investim dhe është ndërtuar një burg i ri, me standarde europiane ndërkombëtare e të tjera me radhë, pavarësisht se flasim për të dënuar ai burg duhet të plotësohet me të gjithë përbërësit e tij, ku burimet njerëzore luajnë rolin kyç.

Pra, nëse atje duhen policë burgu për të hapur burgun, ndërkohë që një pjesë e burgjeve janë mbipopulluar, duke krijuar problematika që nga siguria dhe deri te jetesa e atyre njerëzve që janë aty për të vuajtur dënimin dhe jo për t'u keqtrajtuar, natyrisht duhet që të plotësohet me numër punonjësish, me qëllim që njerëzit që vuajnë këto dënime të shkojnë në këto burgje ku janë krijuar hapësirat për ta. Kjo është e para.

E dyta, nga drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve jam vënë në dijeni se për shkak të sistemit të ri të monitorimit, veçanërisht për kategorinë e të burgosurve shumë të rrezikshëm që po shtohen dita-ditës për shkak edhe të goditjes së Policisë së Shtetit apo edhe të vendimeve të gjykatave e të tjera me radhë, do të ndërtohet një qendër që kërkon edhe teknologji, edhe punonjës në të dyja njësitë që do të krijohen, qoftë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, qoftë te njësia e operacionit “Forca e ligjit”. Pra, do të duhen fonde edhe për këtë, për të mos folur për faktin tjetër, pasi do të ishte e tepërt për ta thënë këtu, por sot që flasim punonjësit e burgjeve nuk kanë uniforma.

Arben Ahmetaj – Për sa u përket uniformave i kanë marrë në vitin 2018, ua kemi dhënë, besoj se po e ekzekutojnë procesin e tenderimit. Në dijeninë time zyrtare, kjo është e saktë, për sistemin e monitorimit kemi dhënë 25 milionë lekë. Vitin tjetër do të marrin gati 40 milionë lekë më shumë. Me ministrin që është përgjegjësja politike e sistemit, jemi rakorduar në qeveri që të riallokojë numrat për të përmbushur nevojat e saj. Numrat i ka të plotë. Janë gati, në mos gaboj mbi 5800 policë burgjesh dhe në diskutimin që kemi bërë në qeveri kemi rënë dakord që brenda numrave mund të riallokojë sa të dojë.

Për sa u përket mjekëve unë e mbajta shënim dhe besoj se e zgjidhim me hapjen e buxhetit të vitit 2019 dhe me atë alokim që ne i kemi bërë për rritjen e pagave.

Anastas Angjeli - Unë propozoj që para përfundimit të plotë të shumës nëse do të akordojmë gjë për Drejtorinë e Burgjeve.

Për sa i përket problemit të mjekëve, ne e thamë, por për problemin e vënies në funksionim të burgut “Jordan Misja”, i cili ka përfunduar dhe kërkohet personeli, të dërgohet menjëherë shkresë në Ministrinë e Drejtësisë dhe atë të Financave. Nëse ata kanë arritur ta rakordojnë çështjen e punonjësve, do të vihen në funksionim apo do të bëjmë shtesën e fondit për ta vënë në funksionim?

Erion Braçe - Më vjen keq, por nuk ka asnjë qindarkë, e kam verifikuar personalisht.

Anastas Angjeli - Ju lutem!

A keni përgjigje tjetër, zoti Ministër?

Arben Ahmetaj – Praktikisht, ne i jemi përgjigjur ministrisë për kërkesën që ka pasur për personel me 70 numra të rinj. Ia kemi dhënë. Ka dalë nga komisionet kjo kërkesë e re, që mund t'i riallokojnë brenda numrave që kanë. Ne me kënaqësi do t'i mbështesim.

Faleminderit!

Erion Braçe- Zoti Angjeli, kur ndahet fondi i pagave, ai jepet për ata që janë. Unë nuk e di se nga do të riallokojnë për 200 të tjerë që kërkohen për vend pune në burg. Nëse ju e dini se nga dalin

Anastas Angjeli - Për këtë duhet të përgjigjen përfaqësuesit e ministrisë. Unë jam...

Erion Braçe - Unë komunikoj me ju zoti Angjeli, ju jeni relator i komisionit.

Anastas Angjeli - Ata duhet të përgjigjen nëse e përballojnë këtë kërkesë.

Erion Braçe - Jo, me ju, nuk kam punë me njeri tjetër.

Edhe një herë, ka normativa se sa punonjës burgu duhen për x të burgosur. Nuk mund të tejkalohen këto histori. Në momentin që tejkalohen shkelet ligji, cenohen kushtet e sigurisë në ato institucione ku kjo gjë bëhet evidente.

Anastas Angjeli - Do të bëj thirrje edhe një herë që të shikohen të gjitha mundësitë që të mbështetet sa është e mundur kërkesa për vënien në funksionim të Burgut 313 edhe nëpërmjet diskutimit që po zhvillojmë sot këtu.

Kalojmë te Akademia e Shkencave, 1 milionë.

Ministria e Sporteve, ka një riallokim 25 me 25 brenda për brenda. Besoj se jemi dakord. Kundër? Nuk ka.

Ministria e Punëve të Jashtme ka një riallokim të brendshëm.

Agjencia Kombëtare e Diasporës, e cila figuron me një kërkesë në 3 drejtime, vetë Ministria e Jashtme, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Diasporës, Fondit Shqiptar për Zhvillim të Diasporës dhe Qendra e Botimeve për Diasporën, për të cilën, nga komunikimi që kemi pasur, qoftë me Komisionin e Politikës së Jashtme, qoftë me Ministrinë e Jashtme, na thanë se kanë rakorduar me ju, zoti Ministër, që të bëhet një shtesë sipas kërkesës në komision. Cili është rakordimi konkret, shuma?

Arben Ahmetaj- Kemi rënë dakord në total që të shtohet 50. Sot në mëngjes kemi rënë dakord me ministrin që të shtohen 80 në total.

Anastas Angjeli - Në total për të tria institucionet brenda ministrisë. Pra, Ministrisë së Diasporës 80 në total.

Faleminderit!

Erion Braçe - Më fal, zoti Angjeli, sa është kërkesa që ka dërguar Komisioni i Jashtëm?

Anastas Angjeli - 140. 80, plus 50, plus 13,8.

Erion Braçe - Para se të fillonte kjo mbledhje, unë mund t'jua lexoj komunikimin me ministrin për Diasporën, më është komunikuar se ka rënë dakord për vlerën e plotë, për të cilën është folur në relacionin e Komisionit për Politikën e Jashtme.

Anasta Angjeli - Këtu thuhet: “ Agjencia Kombëtare 80, Fondi Shqiptar për Zhvillimin 13,8, Qendra e Botimeve 50.

Erion Braçe - Më falni!

Nëse duhet, e ndërpresim mbledhjen, të vijë ministri, zoti Majko këtu. Nëse ka rënë dakord, jemi në rregull, nëse nuk ka rënë dakord, nuk ka rënë.

Mua më ka thënë : “ Kam rënë dakord me të gjitha institucionet qeveritare për këtë gjë”.

Anastas Angjeli- Edhe unë prandaj thashë, zoti Ahmetaj, më tha se ka rakorduar me ministrin për vlerën 80. A është kështu?

Arben Ahmetaj - Për hir të mirëfunksionimit të asaj ministrie, t'i heqim 20 milionë Ministrisë së Financave dhe t'ia bëjmë fondin 100.

Anastas Angjeli - Ka një rialokim dhe një shtesë 5 milionë te Drejtoria e Arkivave. Nuk kemi probleme.

Autoriteti i Konkurrencës 2,5 për investime. Kemi rënë dakord.

Tani po i kthehem edhe një herë çështjes së Radiotelevizionit. Komisioni për Ekonominë ka zhvilluar një mbledhje të posaçme me Radiotelevizionin Shqiptar në Radiotelevizionin Shqiptar për të parë gjendjen reale të zhvillimit të teknologjisë dhe të infrastrukturës së tij dhe ka konstatuar se nevojat e paraqitura nga ky i fundit janë të arsyetuara në disa drejtime kryesore, qoftë në drejtim të investimeve, qoftë në drejtim të teknologjisë, qoftë të detyrimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave për Orkestrën Sinfonike të Radiotelevizionit Shqiptar, të cilat i ka argumentuar edhe në Komisionin për Medien për shumën 490 milionë lekë. Zoti Ministër, a keni mendime?

Arben Ahmetaj - Siç e diskutuam edhe bashkë, ne jemi në gjendje që pas rakordimit të rialokojmë 200 milionë lekë për Radiotelevizionin Shqiptar. Ndërkohë kemi edhe një rialokim që nuk e përmendëm...

Anastas Angjeli - ...që është i këtij fundviti, por që është i buxhetit të ...

Këto janë kërkesat.

Arben Ahmetaj - Është edhe Ministria për Infrastrukturën.

Anastas Angjeli - Kërkon rialokim të brendshëm. Kemi rënë dakord për këtë dhe nëse ju mendoni se shuma e kërkuar nga Radiotelevizioni me dy mënyra, me mënyrën e këtij fundviti dhe me mënyrën tjetër plotësohet, pa dyshim që ne e mbështesim për arsye se gjendja atje, sidomos e arkivit, ishte skandaloze. Atje bëhet fjalë për një pasuri kombëtare, e cila është drejt zhdukjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në buxhetin e vitit të ardhshëm vini 200 milionë dhe sivjet, në fundvit, keni atë që keni thënë.

Ata e fillojnë veprimtarinë me pagim kësti dhe jo më gjë tjetër.

Arben Ahmetaj- Çdo njësi shtetërore publike jobuxhetore ka detyrim që të rakordojë shpenzimet me të ardhurat. Kanë një tarifë shqiptarët në kurriz për televizionin dhe ndërkohë me të drejtë buxheti e subvencionon. Këto ishin mundësitë që ne mund të rialokojmë 200 milionë. Pastaj në vazhdimësi, sa herë që kemi pasur mundësi në fund të vitit i kemi kaluar Radiotelevizionit aq sa...

Anastas Angjeli- Gjykimi i Komisionit është mbi bazën e një realiteti që konstatuam të gjithë anëtarët e komisionit, duke qenë prezent dhe duke zhvilluar një mbledhje atje.

Arben Ahmetaj – 4-5 bashki...

Anastas Angjeli – Jo e thamë atë. Ndryshimin që thamë për ato bashkitë. I kam mbajtur shënim, mos u shqetëso!

Zoti Braçe, keni gjë ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Po, kam zoti Angjeli.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Po më thotë Frani diçka që duhet ritheksuar se nuk qenka ritheksuar në komision: për klubet e shumë sporteve, që do të kalojnë te bashkitë.

Anastas Angjeli - E thashë: rialokimi në Ministrinë e Arsimit për grupet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më duket se e kam lexuar fjalë për fjalë atë. E theksova shumë mirë.

Fjalën e ka zoti Braçe!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ka edhe një gjë tjetër zoti Anastas, që duhet ta theksojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kryeministri ka kërkuar një riformulim për aneksin 3 të FSHZH-jë.

Anastas Angjeli – Po, jam dakord me riformulimin, por para se të konkludojmë me tabelën, e ka kërkuar fjalën zoti Braçe.

Erion Braçe – Ka qenë një kërkesë e disa deputetëve të Kuvendit, e konsultuar edhe me zëvendëskryeministren nga e cila kam marrë një letër. Kërkohet një fond rreth 25 milionë lekë për analizat për fëmijët me sindromën daun. Unë nuk dëgjova të përmendej gjëkundi. Kjo është një çështje shumë e rëndësishme për këtë kategori.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, për testet. Jam shumë i qartë. Për testin.

Anastas Angjeli – Pjesa që i kemi dhënë Ministrisë së Shëndetësisë, zoti Ministër, është për disa bashki, të cilat nuk kanë në qendrat e tyre shërbim të urgjencës, që është rreth 10 milionë lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kërkesa që përmendi zoti Braçe, është diskutuar edhe dje në grupin parlamentar, ka të bëjë me një çështje tjetër. Kërkesa është për një fond rreth 25 milionë lekë.

Arben Ahmetaj – Le t'i riallokojë ministrja brenda fondit!

Do t'ia vëmë kusht.

Anastas Angjeli – E kemi diskutuar me ministrinë, por ajo nuk e ka bërë një rialokim të tillë. Në qoftë se ju...

Arben Ahmetaj – Do t'ia bëjmë ne.

Anastas Angjeli – Atëherë, në ndryshimet që do të bëhen, do të riallokojnë 25 milionë lekë për çështjen që u propozua këtu.

Arben Ahmetaj – Dakord, brenda fondit të saj, do të riallokojmë këtë fond prej 25 milionë lekësh.

Anastas Angjeli – Atëherë, ky është një amendim tjetër.

Arben Ahmetaj – Jo, jo.

Erion Braçe – Mos na detyroni të votojmë kundër buxhetit, zoti Angjeli!

Anastas Angjeli – Ju lutem, më thoni cili është propozimi juaj, zoti Braçe!

Erion Braçe – Të them të drejtën, kjo është një çështje që as tolerohet dhe as tejkalohet. Po bëhet fjalë për fëmijët, që lindin me këto dy sindroma dhe testi për të cilët kushton 180 euro. Bëhet fjalë për fëmijë që janë në familje që edhe kanë, edhe nuk kanë mundësi. Kjo nuk tolerohet as me riallokime, as me akrobaci brenda buxhetit të një ministrie.

Për sa kohë është komunikuar në vijimësi me deputetët, me komisionet, me zëvendëskryeministren, se unë prej saj e mora vesh dhe nuk e dija këtë pjesë dhe nuk e dija se sa kushtonte një analizë e tillë, kjo është çështje e këtij komisioni dhe ky komision le t'i gjejë ku të dojë paratë dhe ta vendosë.

Anastas Angjeli – Dakord.

Kush është dakord të shtohen 25 milionë lekë në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë të dedikuara për këtë çështje, të ngrejë dorën!

Jemi dakord të bëhet me shtesë, jo me rialokim.

Erion Braçe – Kemi qenë të gjithë në Radio Televizionin Publik Shqiptar. Unë për herë të parë pas 100 vjetësh, kam shkelur në atë televizion, që nuk më shërben mua. Për fat të mirë, me reformën që është ndërmarrë atje, ai i shërben nga fillimi deri në fund, publikut.

Tarifa që përmendët këtu, që shpesh është bërë objekt për të ushqyer të gjitha hienat, që i vinë rrotull RTSH-së, natyrisht është një tarifë që justifikohet plotësisht, madje tejkalohet me shërbimin që RTSH-ja po ofron tashmë për mbi 10 kanale të dedikuara për të gjithë, përfshirë edhe Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

A i mbulon kjo tarifë të gjitha shpenzimet? Jo, nuk i mbulon, sepse ka edhe një element tjetër shumë të rëndësishëm. Agjenti tatimor, që mbledh tarifën, merr jo pak, por 10% të vlerës së asaj tarife. Nuk ka asnjë agjent tatimor, jo në Shqipëri, por në botë, që të marrë 10% të vlerës për një tarifë, që vendoset fare kollaj në një faturë dhe ekzekutohet menjëherë. Pra, është edhe kjo anomali.

Ashtu siç ju e konstatuat vetë në mënyrën më të qartë të mundshme, që situata teknike dhe teknologjike e RTSH-së është katastrofike. Ju e patë vetë kur hymë në një ambient të rikonstruktuar, por kaluam edhe në një ambient, i cili ishte i trashëguar. I dëgjuat vetë punonjësit atje që flisnin për një situatë emergjente, sidomos për sa i përket sistemit elektrik në të gjithë RTSH-në. Rreziku atje ishte permanent, jo vetëm për ndërprerjen e transmetimit, por edhe për jetën e atyre njerëzve që punojnë atje. Kështu, është shumë e rëndësishme që ne të adresojmë të gjithë problematikë, që zotërinjtë e RTSH-së kanë adresuar te ne dhe në komisionin respektiv prej disa vitesh.

Kështu, kjo shifra që është vendosur këtu me kërkesën e RTSH-së, e detajuar sipas zërave, është tërësisht e arsyeshme edhe për misionin që ka marrë RTSH-ja që prej 2 vjetësh, që ka një trajektore tërësisht pozitive në shërbim të publikut, jo në shërbim të partisë.

Madje, për shkak të partisë RTSH-ja u shërben pa pagesë edhe të gjitha kanaleve të tjera televizive. E përsëris, e bën pa pagesë, ndërkohë që për çdo lloj transmetimi, këto televizione

kërkojnë pagesa nga RTSH-ja, ky i fundit është detyruar nga ne që të shpenzojë dhe të ofrojë shërbim pa pagesë për të gjithë konkurrentët në treg. Kështu, do t'ju lutesha shumë t'i gjejmë vendin dhe të adresojmë kërkesën e RTSH-së. Unë nuk kam dalë ndonjëherë në RTSH, as do ta bëj ndonjëherë këtë, as kam ndërmend të punoj ndonjëherë atje.

Do t'ju lutesha shumë t'i referoheni në parim dhe të shikoni sidomos rrezikun që kanoset atje nga situata e rrjeteve teknologjike brenda RTSH-së dhe rrezikut që u kanoset drejtpërdrejt në fillim punonjësve dhe më pas godinës së RTSH-së.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Braçe!

Ka ndonjë koment nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për RTSH-në. Kjo është çështja e fundit, që po diskutojmë.

Ka ndonjë koment shtesë nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Ministër!

Arben Ahmetaj – Zoti Angjeli,

Unë nuk kam asnjë mundësi përtej shumës prej 200 milionësh për të cilën ramë dakord për RTSH-në.

Anastas Angjeli – Për vitin e ardhshëm?

Arben Ahmetaj – Po, për vitin e ardhshëm.

Anastas Angjeli – Po për këtë vit?

Arben Ahmetaj – Për këtë vit do të flasim në fund, në dhjetor. Nuk flasim dot tani. Do të flasim më nga afër dhe më me detaje në dhjetor. Brenda buxhetit të vitit 2019, përtej mundësive të buxhetit, janë 200 milionë lekë, të cilat do të shkojnë për RTSH-në me kërkesë dhe në legjitimitet të vizitës suaj atje. Nuk kam mundësi për asnjë cent më shumë.

Anastas Angjeli – Fjalën e ka zoti Braçe!

Erion Braçe – Kur folëm në RTSH kërkesat që bëri drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, i referoheshin ligjit.

Orkestra simfonike e RTSH-së, që është një pasuri kombëtare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka qejfe të ndryshme. Njerëzit mund të dëgjojnë edhe tallava, edhe *despacito* me video etj. Ky nuk është ndonjë problem i madh.

Ne nuk detyrojmë njeri, por kur ligji thotë se shpenzimet e orkestrës së RTSH-së duhet të përballohen nga buxheti i shtetit, duhet të përballohen nga ai. Në të kundërt, pa asnjë lloj

diskutimi, të gjithë që jemi këtu, të biem dakord që do të shkelim ligjin duke mos i dhënë para. Ta themi, që do të shkelim ligjin.

Shërbimi në gjuhë të huaj për shqiptarët jashtë vendit, që nuk kushton pak, por kushton shumë e të tjerat me radhë, janë detyrim ligjor, që buron nga ligji për RTSH-në.

Në momentin që ne biem dakord këtu që do të shkelim ligjin, të themi që do ta shkelim ligjin dhe nuk do të japim para për këtë punë. Nuk kemi asnjë mundësi që ne të japim para dhe të shkelim ligjin. Shumë mirë! Le ta marrin përgjegjësinë të gjithë ata që thonë se nuk do t'u japim para këtyre njerëzve, duke shkelur ligjin. Kjo është shumë e qartë. Do të shkelim ligjin. Shumë mirë! Kush e merr përsipër, le ta çojë deri në fund këtë pjesë!

Pjesa tjetër që ka kërkuar drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, bën fjalë për atë që ju thashë, për detyrimet që i kemi vendosur ne RTSH-së për t'u shërbyer të tjerëve, që janë shpenzime në kurriz të RTSH-së. Dakord, nuk doni të jepni para? Shumë mirë! Që nesër po e ftoj unë drejtorin e Përgjithshëm të RTSH-së të mos ofrojë shërbim pa pagesë për askënd. Zero.

Përndryshe, drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, le të përballet me ligjin. Ose jepini pagesat, ose mos e merrni në qafë atë zotëri, se nesër, pasnesër mund t'i vijë dikush dhe t'i thotë se do të përballet me drejtësinë se ka shkelur ligjin si gjithë të tjerët. Është shumë e rëndësishme kjo pjesë.

Po e përsëris, si në rastin e argjaturave: në rast se në RTSH për shkak të situatës së rrjeteve teknologjike ndodh larg qoftë të ketë ngjarje të rënda, unë i pari do të kërkoj përgjegjësi penale për secilin që e dinte dhe vendosi ta refuzojë ndihmën në këtë drejtim.

Po jua them me zë dhe mbajeni mend po nuk e bëra!

Ervin Bushati – Do të bëj një ndërhyrje të shkurtër.

Dakord, aty edhe pjesa e ruajtjes dixhitale është shumë e rëndësishme, është pasuri kombëtare. Për momentin nuk më duket edhe aq ekstreme dëshira për të hapur edhe kanale të tjera. Nuk mendoj se 200-milionëshi është shifër e vogël për t'u nxjerrë nga buxheti i shtetit në qoftë se mund të rinegociohet kontrata. Aty na u tha se kontrata për të mbledhur paratë ka qenë me CEZ-in në atë kohë, kështu që në qoftë se rinegociohet dhe bëhet me norma marrje komisioni deri në 1,5%, ja një 8%-sh më shumë mund t'i shkojë në të ardhura, që nuk është pak. Nuk e di si janë pastaj modalitetet, sepse kontrata fillestare ka qenë me CEZ-in, ndërsa sot kalon tek OSHEE-ja. Në qoftë se ato mund të marrin norma të kuptueshme 1,5% sa bankat, atëherë, ja një 8%-sh doli më shumë tek të ardhurat e...

Në qoftë se thuhet që 200 milionë...

Ne folëm për Kontrollin e Lartë të Shtetit për 2 milionë lekë të rinj më shumë dhe nuk gjendeshin. Më duket shifër e madhe në krahasim me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Jo, fare!

Më pëlqeu shumë kjo, ndaj do ta marr edhe këtë që tha zotëria...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo thjesht kontratën, mor, por vlerësimin që bëri zotëria për...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Siç jua thashë, nuk kam asnjë lek më shumë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta ndihmoj për ta rinegociuar kontratën me shumë kënaqësi.

Anastas Angjeli – Për Ministrinë e Diasporës ramë dakord në total jo 80, por 100.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për Radiotelevizionin, dua ta hedh në votim shumën e propozuar nga Radiotelevizioni, 490 milionë. Kush është dakord që të mbështetet për 490 milionë Radiotelevizioni Publik Shqiptar në buxhetin e vitit 2019?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, mos ndërhyini në votim!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk lejohet ndërhyrja në votim!

Ju lutem, zoti Ministër!

(Diskutime në sallë)

Në mes të votimit...

Ju lutem, mos ndërhyini!

Zoti Ministër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Më falni, zoti Angjeli!

Para se ta hidhni në votim, për deputetin Ervin Bushati, meqenëse ishte atje dhe meqë është gjithmonë prezent në Radiotelevizionin Publik Shqiptar, shërbim për shqiptarët jashtë kufijve dhe shërbim në gjuhë të huaj, që është detyrim ligjor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, pra!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dëgjoje edhe këtë, or burrë, ke dëgjuar gjithë ato gjëra me mesazhe, me voice, me të gjitha...!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dëgjoje edhe këtë, se nuk të gjen gjë!

Pra, detyrim ligjor 240 milionë lekë.

Vazhdojmë: Orkestra Simfonike e Radiotelevizionit Publik Shqiptar, 60 milionë lekë.

200-milionëshi yt nuk plotëson asnjërën nga këto dy detyrime ligjore!

Doni ta shkëlpi ligjin? Shkëleni, pa asnjë lloj problemi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shkëleni ligjin, pa problem fare!

Anastas Angjeli – Zoti Bushati, një minutë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Ore, shko ndrysho ligjin dhe bëje, mor burrë, pa asnjë lloj problemi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Zoti Ministër...

(Diskutime pa mikrofon)

Në qoftë se për vitin tjetër lëmë 200, ndërkohë që ju thatë se gjatë këtij viti do të ketë një rialokim që i afrohet, por e thatë: si, me kismet, në fund të vitit, a ka ndonjë përafrim, ndonjë ide të një shifre që, po të mbliidhen të dyja shifrat, afrohet në plotësimin e nevojave të...?

(Ministri Ahmetaj flet pa mikrofon.)

Arben Ahmetaj – Në parim do të isha që të akomodonim ato kërkesa të mundshme brenda 200-milionëshit. Përtej saj, çfarë do të kemi mundësi në dhjetor, do ta diskutojmë sërish dhe do të bëjmë atë që kemi mundësi të bëjmë, brenda fondeve që do të na krijohen. Ky është i gjithë diskutimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Kemi ndonjë gjë tjetër?

Ka njeri gjë tjetër për të shtuar?

Erion Braçe – Jo, fare, por kjo është si ajo puna e deputetit Beqiraj, që tha atë ditë këtu!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja kështu do të ngelemi, pa merak! Nuk do të kemi vetëm deputetin Beqiraj, por do të keni edhe drejtorin e Përgjithshëm të Radiotelevizionit Publik Shqiptar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Prandaj edhe unë kërkova...

Erion Braçe – Në fakt, edhe e çliruat. Ai thotë: tani e shkelën ata ligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli –një prononcim me shifra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë pyeta disa herë: a ka njeri diçka tjetër për të thënë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, brenda të gjithë tabelës që përmenda. Para se të kalojmë në votim do të them procedurën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Xhakolli – Kemi bërë një propozim për shpërndarjen e fondeve të pakushtëzuara për bashkitë, meqenëse është edhe drejtori. Duhet bërë një riformulim përderisa ka qytete që në tre-katër muaj presin më shumë sesa dyfishin e popullsisë. Përderisa faktori kryesor ku ju bazoheni është numri i qytetarëve që ju shërbejnë...

Për shembull, për Pogradecin gati trefishohet në tre muaj. Atëherë, fondi i pakushtëzuar që qeveria u jep bashkive duhet riparë për qytetet turistike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë kisha.

E kemi thënë kur e kaluam, apo jo?

E kemi shënuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Anastas...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Urdhëroni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, këtë e kemi diskutuar jo vetëm këtu, por edhe kur kishim me Kryeministrin, madje i kemi kërkuar Ministrisë së Financave që të bëjë propozimin për ndryshimin e formulës. Kur të na e sjellë propozimin, do ta bëjmë, sepse sot nuk ka sjellë propozim për ndryshimin e formulës.

Këtë ia kam kërkuar zyrtarisht, ia kam thënë edhe ministrit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Po, mor, patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – ...edhe këtyre ua kam thënë. Kur të jenë gati, të na e paraqesin ndryshimin e formulës, me qëllim që të shohim nëse është e mundur të ndryshojë formula për të konsideruar, minimumi katër muaj thamë, për këtë çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni ndonjë gjë tjetër?

Erion Braçe – Po, po, ka.

Anastas Angjeli – Në rregull.

Erion Braçe – E para është kjo që thotë zoti Xhakolli, që unë mendoj se është shumë e rëndësishme. Për sa kohë numri i turistëve po rritet në mënyrë eksponenciale dhe disa bashki po mbajnë në kurriz të gjithë fluksin e rritur të turizmit në këtë vend, sidomos të turizmit të huaj, dhe kur janë nën presionin maksimal që, natyrisht, të përmirësojnë edhe shërbimet, ndeshen me turistë që vijnë që nga Amerika nga Polonia, nga Çekia e me radhë, pra do të duhet medoemos që këto bashki të kompensohen për ato tre-katër muaj që presin këtë fluks turistik tashmë ndërkombëtar, jo vetëm kombëtar.

E dyta, është në fuqi një vendim i Këshillit të Ministrave, kjo natyrisht reflekton pastaj edhe në buxhetet respektive, që i ndan bashkitë me kategori. Për fat të keq, i ndan me kategori edhe në nivelin e pagave për punonjësit e tyre.

Unë nuk arrij ta kuptoj se cila është diferenca, për shembull, ndërmjet Bashkisë së Himarës dhe Bashkisë së Sarandës, që janë kategori të ndryshme, dhe që pagat në këto bashki janë me diferencë të madhe, gjë që i ka bërë këto bashki, që të klasifikohen në kategori të ulëta, në emergjencë të burimeve njerëzore. Nuk u shkon kush me ato para që janë vendosur në atë vendim të Këshillit të Ministrave dhe, nga ana tjetër, nuk u shkon kush edhe me buxhetin respektiv që është vendosur.

Kjo ishte për sa i përket çështjes së bashkive që ngriti zoti Xhakolli.

Tani kam një çështje tjetër.

Duke parë me vëmendje deklaratimet në kohë gjatë vitit që shkoi, të bëra në Komisionin e Ekonomisë për një çështje që është tejet e rëndësishme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi ngritur një çështje në vijimësi në këtë komision, që është çështja e aftësisë së kufizuar dhe pagesës për aftësinë e kufizuar për një kategori që, në gjykimin tonë, edhe vitin që shkoi, është penalizuar fort, është penalizuar rëndë: e ndarë në dy grupe, ku njëri grup e ka aftësinë e kufizuar të lindur dhe që, për shkak të kushtit që duhet një vit sigurime shoqërore, në pesë vjetët e fundit nuk e përfiton më pagesën e aftësisë së kufizuar, pavarësisht se nga pikëpamja

shëndetësore të gjitha raportet janë që duhet ta përfitojë, ndërsa grupi tjetër është ai që për dhjetë, njëzet, njëzetepesë, tridhjetë, tridhjetepesë, madje ka edhe dyzetë vjet punë dhe kontribute sigurimesh shoqërore në të dyja regjimet, andej dhe këtej, në momentin që bien në gjendjen e aftësisë së kufizuar, pavarësisht vendimeve të komisioneve mjeko-ligjore, nuk e përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar për shkak se nuk kanë një vit sigurime shoqërore në pesë vjetët e fundit, madje edhe kur ata e gjejnë mundësinë që ta mbulojnë atë vit me sigurime shoqërore, u thuhet: “Jo, se duhet ta kishit paguar para se sa t’ju ndodhte kjo gjë”. Pra, njerëz të cilët kanë paguar nga 40 vjet sigurime shoqërore, nuk e përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar.

Kjo çështje nuk është e panjohur, kjo është e njohur, sepse këtë çështje e kemi bërë të qartë edhe gjatë vitit që shkoi.

Si komision kishim lënë një detyrë që brenda muajit mars të këtij viti që po mbyllet do të kishim një zgjidhje, ndërkohë që nuk kemi zgjidhje për këtë gjë. Natyrisht, do të ishte e tepërt t’ju kujtoja apo t’ju lejoja që ta vendosim përsëri në relacion për deri në fund të muajit mars të vitit të ardhshëm.

Këto janë dy çështjet që kisha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anastas Angjeli – Atëherë, u ngritën dy probleme.

Problemi i parë kishte të bënte me çështjen e bashkive, të cilat gjatë periudhës së verës kanë një fluks të madh. I kemi kërkuar Ministrisë së Financave që brenda muajit mars, propozoj unë, të na dërgojë një përgjigje me shkrim rreth çështjes...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo për atë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duroni, një minutë!

Pra, për çështjen e bashkive që kanë mbipopullim për shkak të turizmit, edhe pse ato sigurojnë të ardhura më të mëdha nga ky aktivitet, do t’i lutesha shumë Ministrisë së Financave që brenda muajit mars të shikojë mundësinë, së bashku me USAID-in apo me ata që e kanë asistuar bërjen e ligjit, se çfarë faktori mund të marrë parasysh për të korrigjuar me një koeficient të caktuar këto mundësi, dhe të na informojë.

Lidhur me çështjen e dytë, ju kemi thënë se nga vështrimi që kemi bërë për disa bashki, një numër shumë i kufizuar bashkish kishte nevojë për një rregullim të grantit. Do ta shikoni dhe do ta vendosni në relacionin përfundimtar.

Së treti, çështja që diskutoi zoti Braçe ka shumë rëndësi. Është një çështje sociale, e cila ka krijuar shqetësim në çdo cep të territorit të vendit tonë, sepse kudo ka shtresa sociale të prekura. Është një çështje që nuk është objekt i neneve të projektligjit për buxhetin. Kjo çështje është objekt i një ligji të veçantë, që lidhet me trajtimin e kësaj shtrese, për të cilën, siç u theksua edhe nga zoti Braçe, kemi kërkuar që vitin e kaluar të na jepej një zgjidhje. Ende nuk na e keni dhënë zgjidhjen.

Ju lutem, shënojeni dhe dërgojeni përsëri, përveç asaj që deklarua këtu, edhe vendimin e komisionit, që brenda muajit mars ne kërkojmë zgjidhjen ligjore të këtij problemi.

Në përfundim, mbas diskutimit dhe miratimit të ndryshimeve të kërkuara dhe gjetjes së burimit të financimit të shpenzimeve të ndryshuara, ju kërkoj të futemi te votimi i neoneve të projektligjit për buxhetin.

Neni 1, me amendamentin e propozuar nga relatorët, bazuar në propozimet e bëra nga komisionet, që do të shkojë në Kuvend si amendament i Komsionit të Ekonomisë, për të ardhurat dhe shpenzimet do të ndryshojë me shumat për të cilat ramë dakord në tabelën që diskutuam, duke ruajtur deficitin.

Kush është kundër? Abstenim?

Arben Ahmetaj – Kam një sqarim, nëse mundem.

Shumat do të jenë me burime brenda shumës së shpenzimeve 519 377.

Anastas Angjeli – Thashë pa prekur deficitin.

Arben Ahmetaj – Deficitin e prek edhe ndryshe, shef Anastasi, e prek duke rritur njërin, duke rritur edhe tjetrën.

Anastas Angjeli - Unë thashë pa e prekur deficitin, nuk thashë e prek.

Ju lutem! Do të na informoni për burimet e përballimit të shpenzimeve.

Arben Ahmetaj – Brenda 519 377-s.

Faleminderit!

Anastas Angjeli – Ne duam të zgjidhim të gjitha problemet që përmendëm...

Neni 1, me ndryshimet që thamë.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Në qoftë se do të ketë influenza nga ndryshimet që bën neni 2, do të miratohet me ndryshimet e vendimit që morëm këtu.

Kush është kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3, do të ketë ndryshmin përkatës me propozimin që bëmë.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4.

Kush kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5.

Kush është kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6.

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7.

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8.

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9, kufiri i financimit të deficitit.

Kush është kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10, shpenzimet e buxhetit të shtetit sipas grupeve kryesore.

Nuk dua të përsëris fjalinë që kam thënë që në fillim për tabelën që diskutuam dhe miratuam.

Kush është kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11, numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë, me shtesat që propozuam në tabelat përkatëse.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12.

Kush është kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14.

Besoj se jeni të gjithë dakord për rritjen e fondit të pagave.

Kush është kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15.

Kush është kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet me sugjerimin që kam bërë.

Neni 17.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 19.

Te rreshti i tretë ka një gabim, është viti 2018 dhe duhet bërë viti 2019. Të korrigjohet.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet me ndryshimin e korrigjimit.

Neni 20, stoku i borxhit.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 21.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 22.

Kush është kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 23.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Votojmë në tërësi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2019”.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Erion Braçe – Zoti Angjeli, një sekondë, të lutem!

Anastas Angjeli - Përpara votimit, zoti Braçe ka kërkuar fjalën.

Erion Braçe – Siç e ndoqët, unë dhe kolegët e tjerë, përmendëm disa çështje, që kanë nevojë për mbulim financiar. Mbi të gjitha, çështja për analizën e fëmijëve me sindromën Down dhe me autizëm, pastaj çështjet e tjera me radhë: punonjësit e Gardës së Republikës së Shqipërisë, punonjësit e burgjeve, hapja e burgjeve të reja, rritja e sigurisë, ashtu siç qeveria, Kryeministri, ministri i Brendshëm, ministrja e Drejtësisë, kanë marrë angazhim për situatën në burgje. Për të vijuar më pas edhe me çështje të tjera shumë të rëndësishme, siç është ajo e argjinaturave në Ministrinë e Bujqësisë apo ato që kanë të bëjnë me Radiotelevizionin Publik Shqiptar.

Sapo dëgjova, që të gjitha këto çështje do të akomodohen brenda tavaneve buxhetore që janë vendosur. Propozimet që ne kemi bërë (propozimet që kam bërë unë) janë krejt të ndryshme. Në qoftë se këto propozime nuk merren parasysh, e kam të pamundur të votoj ligjin për buxhetin e shtetit.

Anastas Angjeli – Faleminderit, zoti Braçe!

Votojmë projektligjin në tërësi.

Kush është dakord?

Miratohet në tërësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...për të proceduar.

Siç ju thashë, relacioni i komisionit do të jetë i detajuar, me propozimet dhe burimet konkrete. Përpara se relacioni t’i shkojë parlamentit, që mblidhet në datën 3 dhjetor për ta diskutuar nen për nen dhe për ta miratuar, me ndryshimet e propozuara dhe me burimet e të ardhurave që do të vendosen, do të verifikohen edhe një herë një për një, pasi, siç ju thashë, do të shkojnë në formën e ndryshimeve që i bëhen projektit të buxhetit të vitit 2019.

Ishte një mbledhje maratonë.

Dua të falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit dhe komisionet e tjera, për punën shumë serioze dhe të gjatë për një muaj, që kanë zhvilluar mbledhje edhe 2 herë në ditë, në të njëjtën kohë, dhe për vendimet e vlefshme që janë dhënë për përmirësimin e paketës fiskale dhe të buxhetit!

Ju falënderoj edhe ju, zoti Ministër, si dhe stafin tuaj për prezencën, duke besuar se detyra më e rëndësishme është zbatimi i buxhetit me rigorozitet, çelja e tij në kohë, me qëllim që në fillim të vitit ai të jetë menjëherë i zbatueshëm, në dobi të zhvillimit të ekonomisë dhe të qytetarëve shqiptarë!

Faleminderit!

Natën e mirë të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti

